


KATALOGU AKADEMIK EuNC

2017-2018



European
Nazarene
College

MAKING A DIFFERENCE
THROUGH EDUCATION

KATALOGU AKADEMIK 2017-2018

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	5
A. PROFILI I EuNC-së	5
B. Deklarata e Besimit	6
C. Misioni i KEN-it	6
D. VLERAT E EuNC-së	7
E. Motoja, Unikaliteti dhe Dallueshmëria e EuNC-së	8
F. KARAKTERI I EDUKIMIT te EuNC-se	9
G. HISTORIA E EuNC-SE	9
H. AKREDITIMI, NJOHJA, DHE MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT.	11
I. QËNDRAT MËSIMORE DHE VENDNDODHJET E MËSIMDHËNIES	12
J. BORDI I BESUAR	14
II. POLITIKAT AKADEMIKE	16
A. PRANIMI DHE REGJISTRIMI	16
1. Kërkesat Hyrëse	16
2. Kërkesat e pranimit jo zyrtare.	17
3. Përgjegjësitë e Studentëve.	17
4. Zbatimi i Katalogut	17
5. Transferimi i Krediteve	18
6. Studimet e zgjatura	19
7. Qartësimi i Diplomimit	19
8. Përcaktimet e Vitit Shkollor	19
B. Të mësuarit për kursin	20
1. Pesha Akadematike	20
2. Integriteti Akademik	20
3. Pronë intelektuale	20

4. Aftësitë gjuhësore.	21
5. Pjesëmarrja në mësim.	21
6. Rregullat për dorëzimin e detyrave me vonese.	21
7. Vlerësimet e kursit.	21
8. Pëfundimi I kursit.	22
C. Notat.	22
1. Sistemi I notave	22
2. Orët si dëgjues.	23
3. Tërheqja, largimi nga kursi.	24
4. Ngelja – Opsioni I Përsëritjes së Klasës.	24
5. Nota jo e Plotë.	24
6. Pezullimi Akademik.	24
7. Çmimet e Nderit.	25
8. Dëftesa.	25
D. POLITIKAT AKADEMIKE DHE PROCEDURAT.	25
III. FINANCAT	27
IV. PRITJA E REZULTATEVE DUKUESE.	29
V. PLANI MESIMOR I KEN.	31
A. HYRJE	31
B. KORNIZA E KURRIKULËS.	31
C. PERSHKRIMI NE PESE TOGJEVE.	31
D. KEN DHE PROCESI I BOLONJËS	33
E. ZHVILLIMI I STUDENTEVE NE KEN.	35
1. Qëllimi dhe funksioni.	35
2. Përmbledhje	36
VI. PROGRAMET E EuNC/KEN-IT.	39
A. CERTIFIKATA E FORMIMIT SHPIRTEROR (CFSH) DHE KUALIFIKIMI NE FORMIMIN SHPIRTEROR (KFSH)	39
B. DIPLOMA E SHËRBESËS SË KRISHTERË DHE KUALIFIKIMI NE SHËRBESËN E KRISHTERE.	41

VII. KËRKESAT ARSIMORE për SHUGURIM	44
VIII. NUMRAT E KURSEVE	44
IX. PËRSHKRIMI I KURSEVE	47
X. DREJTORIA E FAKULTETIT.	59
XI. DREJTIMI I PËRGJITHSHËM DHE ADMINISTRIMI	67
XII. Qëndrat Mësimore	70
XIII. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME	79

I. HYRJE

A. PROFILI I EuNC-së

Kolegji Teologjik Nazaretas (EuNC) është një shkollë **profesionale** mbi shërbesën që përgatit personat për shërbesë të Krishterë. Kjo do të thote që EuNC/KEN dëshiron të ndihmoje studentet për t'u përgatitur për shërbesë në kisha apo në organizata të krishtera.

Programi i edukimit të EuNC/KEN-it bën pjesë në institucionin edukues **Nazaretas**. Kjo do të thotë që ky program reflekton traditën e teologjisë Uesleane (Wesleyan), por jo në mënyrë ekskluzive. Kjo implikon gjithashtu që programi i ofruar nga KEN-i ka për qëllim të përmbushë kërkesat për edukim të Kishës së Nazaretasit për të marrë shungurimin në Rajonin e Eurazise.

EuNC ka për qëllim të ofrojë një **program mësimor të akredituar dhe jo te akredituar**. Certifikata ne Formimin Shpirtëror (60 ECTS) dhe Diplome ne Sherbesen e Krishtere (120 ECTS). EuNC eshte i akredituar nga European Evangelical Accrediting Association (EEAA) dhe siguron hyrjen ne nivelin e arsimit trecial. Kualifikimet ne Formimin Shpirtëror (60 Kredite) dhe ne Shërbesën e Krishterë (120 Kredite) jane gjithashtu edhe jo te akredituara.

EuNC është një shkollë me qendra studimi në **shumë shtete të ndryshme**, dhe me një qendër administrimi dhe shumë qendra studimi. Anetarët e fakultetit jetojnë dhe shërbejnë në shumë shtete të ndryshme, ndërkohë që studentet marrin leksione me kohë të pjesshme në një nga këto qendra studimi. EuNC nuk është e kufizuar nga një ndërtesë e vetme apo vënd të vecantë, por është një rrjet edukimi që përfshin persona që jetojnë dhe punojnë në shtetë të ndryshme të Evropës.

KEN-i shërben **kontinentit të Evropës dhe shteteve të ish Bashkimit Sovjetik**, duke ju ofruar atyre një program edukimi dhe njohurie të përbashket. Në këto shtete, kishat po përballojnë sfida të veçanta në shërbesat e tyre, kështu që programi shkollor i EuNC është zhvilluar duke pasur parasysh këto sfida, dhe duke u përpjekur të mbaje në ekuilibër zhvillimin e përbashkët të Evropës dhe shteteve të ish Bashkimit Sovjetik me problematikat e rrethit dhe shteteve të ndryshme.

B. Deklarata e Besimit

KEN-i është një institucion i Kishës së Nazaretasit, dhe si i tillë reflekton keto vlerat thelbësore: Ne jemi njerëz të krishterë, ne jemi njerëz të shenjtë, ne jemi njerëz në mision. Kështu që, edhe programi dhe mësimdhënia, dhe standartet e sjelljes janë të udhëhequra nga Deklaratat e Besimit të Kishës së Nazaretasit. KEN-i mikpret studentët nga kisha të tjera të krishtera që ndiejnë që mund të përfitojnë nga natyra dhe kualiteti i edukimit të ofruar nga KEN-i.

Ne besojmë:

1. Ne një Perëndi-Ati, Biri, dhe Fryma e Shenjte.
2. Që Shkrimet e Dhjata e Vjetër dhe e Re janë dhënë në mënyrë frymëzuese dhe përmbajnë të gjithë të vertetën e nevojshme në besimin dhe jetesën e krishterë.
3. Njeriu lind në një natyrë të rene dhe është i prirur drejt të keqes dhe kjo vazhdon.
4. Të papëduarit janë të pashpresë dhe përjetësisht të humbur.
5. Shlyerja përmes Jezus Krishtin është për të gjithë racën njerëzore, dhe kushdo që beson në Zotin Jezus Krisht është i shfajësuar dhe i shpëtuar nga dominimi i mekatit.
6. Besimtarët janë thirrur të jenë të shenjtë dhe pas rigjenerimit përmes besimit në Zotin Jezus Krisht.
7. Fryma e Shenjte bëhet dëshmi në lindjen e re dhe gjithashtu gjatë gjithë jetës së shenjtërisht të krishterë.
8. Zoti do të kthehet, të vdekurit do të ringjallen dhe gjykimi i fundit do të ndodhë.

C. Misioni i KEN-it

Misioni i Kolegjit Teologjik Nazaretas (KEN) shprehet përmes "Pse" dhe "Çfare" në e bëjmë këto. Kjo është dhe artikulli me I mirë në deklaratën tonë: ***Mundësimi i Disiplinave të Krishtit për Sherbese.***

Mundësimi: Edukimi i të mesuarit nuk është kurrë një qëllim final; është kuptimi i që kjo gjë është e mundur për të mesuar duke u rritur në një person që u shërben të tjerëve.

Dishepuj si Krishtit: Edukimi që KEN ofron ka dëshirë të ndërtojë mbi themele të forta dishepullimi; ai dëshiron të japë mjete të mëtejshme atyre që kanë filluar me kohë që të rriten (dhe vazhdojnë të rriten) si dishepuj të Krishtit, dhe të bëjnë të mundur rritjen e tyre të mëtejshme për shërbesa të krishtera më specifike, të cilat kërkojnë njohuri teologjike të mëtejshme, vetëdijë, dhe më shumë aftësi specifike. Termi Si "Krishti" shpreh transformimin e karakterit të edukimit (duke sjelle ndryshimin përmes të mesuarit përmbajtjen, kopetencat, karakterin në kontekst) dhe traditën e teologjisë së Shenjterine -Wesliane në shkollë.

Sherbimi: Ne i shërbejmë Zotit duke marr pjesë në aktivitetin e Tij shpengues të botës dhe njerezve duke shpallur ungjillin ne bote.

D. VLERAT E EuNC-së

Bazuar ne profilin, besimin, dhe misionin e Kolegjit Teologjik Nazaretas, vlerat e shkolles jane shprehur ne kater deklaratat e meposhtme :

KEN-i është një **komunitet për të mesuar** : Si institut me nivelit të lartë edukimi, KEN është i frekuentuar nga profesore dhe nga ata që dëshirojnë të marrin njohuri për ta perdorur në mbretërinë e Perëndisë. Pavarsisht nga titulli ose roli që mbajnë anetarët e shkolles, të gjithë janë të thirrur të mësojnë nga njëri-tjetri, të jenë të hapur ndaj mësimi të tjerëve, dhe të jene duke u rritur në besimin dhe identitetin e tyre në Krishtin.

Duke qënë një komunitet për të mesuar, KEN është i angazhuar për **integritetit dhe vërtetësi**. Ne besojmë që asnjë udhëtim besimi dhe asnjë arritje e vlerave akademike nuk është i mundur në mënyrë individuale. Ne jemi përgjegjës për njëri-tjetrin në studimet tona ashtu si dhe në jetë. Me siguri, ajo çfarë prek jetën e një personi prek dhe jetën e të gjithë të tjerëve. Duke pasur këto principe në mendje, ne shikojmë cdo padrejtësi akademike si dëm të drejtpërdrejt ndaj komunitetit tonë, dhe ne besojmë që shpërdorimi apo një zemër jo plotësisht e dedikuar ndaj njohurisë dhe të vërtetës, demton jo vetëm individin, por gjithashtu dhe të gjithë komunitetin e atyre që duan të mësojnë.

KEN është një **komunitet besimtarësh**. Anetarët tanë bëjnë të pamundurën për të respektuar dhe vlerësuar njëri-tjetrin. Ne si individe dhe si komunitet mundohemi të bëjmë më të mirën për të arritur një marrëdhënie të ngushtë me Perëndinë duke pasqyruar ngjashmërinë me Të. Jeta që jetojmë nuk është e ndarë në “të shenjtë” dhe në “sekulare”. Çdo gjë që bëjmë e bëjmë përpara Perëndisë duke inkurajuar njëri-tjetrin për të arritur të pasurit të njëten zemër me Perëndinë.

I bekuar në shumë mënyra të ndryshme, KEN është, dhe është i vendosur të vazhdojë të jetë, një **komunitet mirënjohës**. Ne jemi të vetëdijshëm që pak njerëz në botë kanë mundësi të bëjnë pjesë në një komunitet të tillë me këtë nivel akademik studimi. Ne jemi gjithashtu të vetëdijshëm që perfitojmë nga sakrificat dhe angazhimi i të tjerëve. Ndërsa na është besuar njohuria, ne dëshirojmë ta ndajme dhe ta vemë në përdorim të shërbesës. Të mirënjohur për influencën që kemi mbi njëri - tjetrin, ne ftojmë të tjerët të bashkohen me ne me shpresën që mund të prekim në mënyrë më efektive botën që na rrethon. Ne na është ofruar një vënd shpëtimi dhe rritjeje, dhe ne dëshirojmë të zgjerojmë rrethin e një parajse të tillë për të përfshirë njerëz dhe vende të tjera.

E. Motoja, Unikaliteti dhe Dallueshmëria e EuNC-së

Motoja e Kolegjit Teologjik Nazaretas është “ **Te bejme diferencën përmes edukimit**”
Motoja shpreh qëllimin tonë dhe reflekton misionin tonë (“pse” dhe “Cfare” në bejme). Në të njëjtën kohë, kjo mund të lidhet me unikalitetin dhe dallueshmërinë që e bëjnë të shprehur në katër terma me të mirë të mëposhtem:

Transformimi : Në besojmë se edukimi është transformues. Është një pjesë integrale në rigjenerimin e imazhit të Perëndisë të urdheruar për të bërë ndryshimin. Prandaj, përpjekja edukative duhet të fokusojë rezultatet e saj në një transformim holistik të komunitetit të të mësuarit për të bërë një ndikim në shoqëri.

Aplikimi: “Beni ndryshimin përmes edukimit” do të thotë se ne besojmë se ndryshimi është i mundur – në jetën e besimtarëve, në shoqëri dhe për të gjithë krijimin. Perëndia është duke punuar për të arritur qëllimin e Tij për të rigjallëruar krijimin e Tij dhe ne jemi të ftuar të bëjmë pjesë në këtë mision.

Konteksti : EuNC-ja ka vendndodhjet e saj në gjashtëmbëdhjetë vende të ndryshme përrreth Europës dhe Azisë Qendrore, duke ofruar programe në gjuhët e vendeve të tyre. Programi përshtatet gjithashtu për çdo kontekst kulturor ku shkolla është në punë. Përveç kësaj, EuNC-ja, punon shumë ngushtë me kishat dhe rrethet lokale të Kishës së Nazaretasit dhe me partnerët e tjerë Wesleyanë në vende të ndryshme.

Aplikimi: “Beni ndryshimin përmes edukimit” duhet të ndodhë edhe në kontekst. Si EuNC, ne synojmë që duke ardhur në çdo vend, ne jemi të ftuar dhe duke punuar së bashku me partnerët të ndryshëm për të ofruar arsim teologjik në një formë të përshtatshme.

Shumekombësh: EuNC-ja është një shkollë me një program, një fakultet dhe një trup studentor. Në përqafojmë faktin se jemi shumëkombësh, që reflektohet në strukturën organizative, qeverisjen dhe administrimin e shkollës. Anglishtja është gjuha e komunikimit në nivel të administratës së përgjithshme dhe qeverisjes.

Aplikimi: “Beni ndryshimin përmes edukimit” është duke ndodhur jo vetëm në lokalitete, por është një implikim shumëkombësh. Ne e njohim, vlerësojmë, dhe festojmë karakterin shumëkombësh të shkollës sonë. Ne duam të mesojmë me njëri-tjetër dhe nga njëri-tjetri. Kjo na bën të pasur të gjithëve dhe na ndihmon të arrijmë qëllimin e shkollës.

Wesleyan: EuNC-ja është pjesë e traditës së Shenjterisë Wesleyane. Ne is part of the Wesleyan-Holiness tradition. Në theksojmë se hiri i Perëndisë është i lirë për të gjithë dhe i lirë në të gjitha, me qëllim që të ripërtërijë të gjithë krijimin dhe njerëzimin në imazhin e Perëndisë (shenjtëria personale dhe shoqërore).

Aplikimi: “Beni ndryshimin përmes edukimit” është pjesë e trashëgimisë dhe qasjes së teologjive sonë. Ne besojmë se ungjilli është për çdo njëri dhe Krishti mund të ndryshojë jetën e njerëzve dhe impaktin në shoqëri.

F. KARAKTERI I EDUKIMIT te EuNC-se

Në programin e tij të edukimit, KEN bën të pamundurën për të arritur rezultate akademike të shkëlqyera, formim shpirtëror të vashdueshem, praktikë dhe zhvillim të aftësive në lidhje me shërbesën, të cilat janë të shkëlqyera dhe të rëndësishme për kontekstin ku zhvillohen dhe gjithashtu që rrefektojnë ngjashmërinë me Krishtin në sjelljen e Tij si “shërbëtorë shërbese I përqëndruar në tëresinë e personit në kontekstin në të cilin bën pjesë, programi shkollor i KEN-it është projektuar të ndihmojë studentët të arrijnë katër rezultatet e edukimit të përkufizuara nga Kisha e Nazarenasit për përgatitjen e shërbëtorëve të Perëndisë. Katër rezultatet e edukimit janë të lidhura me fushën e njohurisë ose *përmbajtes*, *kompetencës*, zhvillimit të *karakterit* personal, dhe ndjeshmërisë për problemet dhe temat aktuale të *kontekstit* duke qënë se këto të fundit janë të rëndësishme për një shërbesë efektive.

G. HISTORIA E EuNC-SE

Vizioni i kolegjit fillon në 1963 në mendjet dhe zemrat e Xherald Xhonson (Jerald Johnson), shërbëtorë i Perëndisë në Gjermani, dhe Bob Cerato (Bob Cerrato), në Itali. Vizioni ishte për ti shërbyer kontinentit të Europës nëpërmjet trajnimit të personave për përgatitje shërbese. Kolegji filloi në një ndërtesë në një fshat të vogël Gjerman i quajtur Busingen që ndodhet brenda territorit Zvicerian. Mandati i kolegjit ishte të kishte një qëllim internacional, me anglishten si instrument instruksioni, dhe për përgatitjen e personave për Shugurimin dhe shërbesë të Krishterë. Shkolla fillimisht u quajt Kolegji Biblik Evropian Nazaretas (European Nazarene Bible College, ENBC) dhe u themelua në 1965 nga Pastori Xhon B. Nilson (John B. Nielson) i cili ishte dhe rektori i parë i shkollës. Leksioni i parë filloi me 10 Janar të 1966.

Përgjatë egzistencës së tij, kolegji ka qëndruar i fokusuar në përmbushjen e qëllimeve origjinale. Në 1977, shkolla u bashkua me Universitetin Nazaretas të MidAmerikës (MidAmerica Nazarene University, MNU), duke bërë të mundur njohjen e plotë të diplomës Bachelor në Arte (Bachelor of Arts). Në vitet e para të 1990-s, si rezultat i rënies së komunizmit dhe ngritjes së Perdes së Hekurt, shkolla filloi të ofronte edukim teologjik në distancë. Me anë të këtij programi, misioni i kolegjit u zgjerua në mënyrë që të përfshinte kështu studente nga shtete të ndryshme që nuk kishin mundësi të vinin në kolegji në Busingen ose që nuk mund të studionin në gjuhën Anglese. Në 2001-shin, emri i shkollës ndryshoi dhe u bë European Nazarene College (EuNC). Ky ndryshim ka qene i diskutuar për shumë vite, dhe përfundimisht u aprovua me shpresën që emri i ri mund të pasqyronte profilin e institucionit të edukimit në mënyrë më të pershtatshme.

Duke vështuar që shpejtësia e ndryshimeve në ambjentin Evropian dhe vendeve të ish-Bashkimit Sovjetik kërkonin ndryshime themelore në edukimin teologjik që EuNC ofronte për shërbëtorët e Perëndisë, në vjeshtë të 2004, shkolla filloi një projekt 7 vjeçar për ndryshim. Në janar të 2006, Bordi i Besuar (Board of Trustees) pranoi strategjinë e re *Duke Levizur Përpara* i cili doli si rrjellim i këtij projekti. Strategjia mbështet akoma misionin dhe visionin e deklaruar nga KEN si dhe linjat drejtuese të prioriteteve organizative për të ardhmen, për të qene “një shkollë multikulturale dhe multinazionale me një kompleks dhe qendër administrimi, si dhe shumë qendra studimi në shtete të ndryshme të Evropës dhe Shtetet e ish - Bashkimit Sovjetik. Me këtë sistem, shkolla dëshiron që të krijojë mundësinë “për të mobilizuar profesorave dhe studentët mes shkollës dhe qendrave të studimit të ndryshëm, me qëllim që ti ekspozojë me më të mirën e programit rezidencial dhe edukimit të zgjeruar.”

Në vitet në vazhdim KEN implementoi strategjinë *Duke Lëvizur Përpara*. Shkolla përshtati strukturën akademike dhe administrative për të ofruar më shumë mbështetje shkollës me një seli dhe shumë qendra mësimore. Mbi të gjitha, shkolla është një fakultet i vetëm, me një rrejt studentësh dhe profesorësh që jetojnë në vende të ndryshme, dhe me një program shkollor që lë hapsirë për përshtatje të mëtejshme të programit me kulturën ku po zhvillohet. Në 2007/2008 u fillua një program shkollor i ri që merr parasysh kontekstet e ndryshme të ambienteve Evropiane dhe atyre të ish - Bashkimit Sovjetik. Struktura e re është e bazuar në module studimi të cilat janë pjesë e skedave të tjera studimi. Ky kurrikulum lejon pjesëmarrjen e studentave jo tradicional gjithashtu ben të mundur një mobilizim me të zgjeruar të fakultetit. Në të njëjtin vit, shkolla adoptoi sistemin shkollor me kredite ECTS (Europen Credit Tranfer and Accumulation System).

Edhe pse të gjitha objektivat e vëna nga plani strategjik u arritën, gjatë viteve të fundit të këtij plani, 2010-11, shkolla u gjend në një pozicion ndryshe nga ai që kishte parashikuar. EuNC u përball me zhvillime të paparashikuara, si renia e regjistrimeve të studentëve në programin rezidencial, sfidatat me akreditimin e të gjitha qendra të mesimit përmes marrdhënies ekzistuese me MNUn (MiddAmerica Nazarene University), mungesa e burimeve financiare dhe si rrjedhojë mungesa e personelit. Si përgjigje këtyre sfidave, EuNC vendosi të mbyllë programin rezidencial në verën e vitit 2011 dhe të përqëndrohej plotësisht në qendrat e mësimore të shkollës që gjenden në vende të ndryshme të Evropës dhe shteteve të ish Bashkimit Sovjetik. Shitja e tokës në Busingem e perfundua në 2015. KEN është bere perfundimisht nje shkolle ne shume kombe me qendra mesimore ne shtete te ndryshme dhe nje administrate qendrore per te permbushur misionin e shkolles. Vizioni 2020 per planin strategjik u zhvillua ne permbushje te kesaj shprehjeje.

Se bashku me keto ndryshime Nentor te 2012, shkolla mori akreditimin nga Kompania Ungjillore e Akreditimit ne Europe (EEAA) per Certifikaten ne Formimin Shpirteror (60 ECTS) dhe Diplomen ne Sherbesen e Krishtere (120 ECTS).

H. AKREDITIMI, NJOHJA, DHE MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT.

Akreditim nga Shoqata Evropiane Ungjillore Akredituese (European Evangelical Accrediting Association, EEAA). KEN është akredituar nga EEAA (<http://.eeaa.eu>) për programet: Formim Shpirtëror dhe Shërbesës së Krishterë

Riorganizimi i Institucionit të Edukimit Nazaretas.

Kolegji European Nazaretas njihet nga Bordi i Edukimit Nderkombetar (BEM) i Kishes së Nazaretasit si një nga Institucionet e Edukimit të Kishes së Nazaretasit, dhe është pjesë e Edukimit të Eurozazisë të Kishes së Nazaretasit. (www.nazarene.org)

Programet e aprovuara për shërbesat e shugurimit në Kishën e Nazaretasit.

Kualifikimi në Shërbesën e Krishterë dhe në Diplomen për Shërbesën e Krishterë në Kolegjin Evropian Nazaretas janë aprovuar nga Këshilli i Mbikqyrjes Nderkombetar të Kurseve (KMNK) të Kishes së Nazaretasit. Duke kërkuar minimumin e kërkesave për Shërbesën e shugurimit në distriktet e kishes së Nazaretasit në të cilat KEN mundeson edukimin. Çdo distrikt ka kërkesa të qarta shugurimi të cilat janë kërkuar nga KMNK. Me fjale të tjera studentet e KEN-it, të cilët kërkojnë shugurimin u kërkojnë nga distriktet e tyre të perfundojnë një nga dy programet e shërbesës së krishterë. Disa distrikte kërkojnë edhe punë praktike. Është e rëndësishme të kuptojmë që distrikte të vecanta kërkojnë kritere të vecanta- jo nga shkolla. Ndryshimet mes distrikteve janë të mundur. Megjithatë kërkesat për certifikatën në shërbesën e krishterë, janë të njëjta për të gjithë programet e distrikteve.

Marreveshje bashkepunimi me Institucione të tjera.

- Kolegjin Teologjik Nazaretas Manchester, Angli, Mbretëritë e Bashkuara.
- Kolegji i Biblës Nazaretas, Kolorado Springs, Colorado, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- Universiti Nazaretas në Veriperendim të Nampa, Idaho, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- Universiti Nazaretas i Trevekes, Nashville, Tennessee, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- Universiti Nazaretas I Korese, Chonan City, Koreja Jugore.
- Akademie für Weltmission, Korntal, Gjermani
- Seminário Teológico Baptista, Queluz, Portugali,
- One Mission Society, Greenwood, Indiana, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- Evangelisch College, Zwijndrecht, Hollandë.

I. QËNDRAT MËSIMORE DHE VENDNDODHJET E MËSIMDHËNIES

EuNC-ja është një shkollë me një shumëllojshmëri qendrash mësimore në vende të ndryshme të Europës dhe shteteve të ish- Bashkimit Sovjetik. EuNC-ja ofron studime me kohë të pjesshme në anglisht ose në gjuhën amtare në qendrat mësimore vijuese të ndara në fushat vijuese:

Europa Qëndrore	Shqipëri-Kosove; Bullgari, Danimarkë*, Hungari; Rumani
Federata e Shteteve të Pavarura	Armenia, Azia Qëndrore (Kazakhstan, Kyrgyzstan*), Rusia, Ukraina, CIS Online
Europa Veriore	Gjermania*; Hollanda.
Mesdheu Perëndimor	France*, Itali, Portugali, Spanje
Digital Campus	Duke u shërbyer të gjitha fushave dhe qendrave mesimore.

*Në vendet e shënuara me një * ofrohen një numër i kufizuar kursesh, por jo një program i plotë.*

Profili i një Qendre Mësimore Aktive.

1. K1. Kurse të ofruara rregullisht që lejon të gjithë studentet të marrin një minimum prej 15 ECTS, kredite në vit.
2. Programi mësimor i Çertifikatës së Formimit Shpirtërorë (60 ECTS, kredite) dhe Çertifikata e Shërbesës së Krishterë (120 ECTS, kredite). Studentët duhet të jenë të aftë të mbarojnë këto dy programe në 2-4 vjet dhe 4-8 vjet, përkatësisht (15-30 ECTS, kredite në vit).
3. Një program mësimor shugurimi që është ose a) i njëjtë me Çertifikatën e Shërbesës së Krishterë ose b) i zgjeruar, duke ofruar kurseve shtesë në programin e Shërbesës së Krishterë.
4. Strukturë administrative të qartë dhe një personel i aftë për t'ju siguruar një shërbim cilësor studentëve.

5. Udhëheqja e qartë akademike ofrohet nga Koordinator i Qendrës Mësimore. Ky person është përgjegjës për planifikimin e kurseve dhe sigurimin e cilësisë së edukimit. Edukimi siguron kontributin e misionit të KEN dhe reflekton vlerat dhe vizionin e edukimit si transformues, kontekstual, shmekombesh dhe Weslian.
6. Kurset janë ofruar sipas programit mësimor shabllon të vendosur nga Asambleja e Fakultetit të KEN dhe të gjitha garancitë cilësore dhe mjetet vlerësuese janë përdorur
7. Fakulteti dhe profesorët e tij përmbushin kualifikimet e caktuara nga KEN dhe pajtohen me të gjitha procedurat e fakultetit.
8. Studentët kanë mundësinë të organizojnë vetveten në trupin e QM dhe të bëhen pjesë e rrjetit studentorë ndërkombëtar të KEN-it.

Vendodhjet mësimore

Kurset ofrohen në një total prej 45 vendesh, të ndara sipas shteteve të mëposhtme, të listuara sipas rendit alfabetik në anglisht:

Shqipëri	Tirana (ALB1), Gorre (ALB2)
Armenia	Akhuryan (ARM1), CIS Online (CIS1)
Bullgaria	Sofia (BUL1), Razgrad (BUL2), Montana (BUL3)
Danimarke	Copenhagen (DEN1)
France	Paris (FRA1), Montpellier (FRA2)
Gjermani	Online education (GER1); Gelnhausen (GER2)
Hungari	Budapest (HUN1)
Itali	Rome (ITA1), Florence (ITA2), Catania (ITA3)
Kazakhstan	Borovoe (KAZ1), CIS Online (CIS1)
Kosova	Prishtina (KOS1), Suharekë (KOS2)
Kyrgyzstan	Bishkek (KYR1), CIS Online (CIS1)
Hollande	Zaanstad (NET3), Amersfoort (NET4), Dordrecht (NET5)
Portugali	Mercês (POR7)

Rumania	Bucharest (ROM1), Sighisoara (ROM2), Tigmandru (ROM3)
Rusia	Chekhov (RUS1), St Petersburg (RUS2), CIS Online (CIS1)
Spanja	Madrid (SPA1), Barcelona (SPA2), Zaragoza (SPA3), Sevilla (SPA4), Online education (SPA5)
Ukraine	Mariupol (UKR2), CIS Online (CIS1)
Kampusi Digital	Edukimi/Kurse Online (DIG1), Kroacia (DIG2)

J. BORDI I BESUAR

Pushteti i vazhdueshëm i KEN-it është i përqëndruar në duart e bordit të besuar, i cili është i zgjedhur dhe i përfaqësuar nga distriktet e kontinentit të Evropës dhe shteteve të ish- Bashkimit Sovjetik të Kishës së Nazaretasit të përcaktuara nga Rrethi i Euroazisë të Kishës së Nazaretasit dhe fushat e organizuara. Bordi takohet të paktën një herë në vit dhe është i thirrur nga komiteti ekzekutiv. Gjatë seksioneve zyrtare të Bordit të Besuar, Komiteti Ekzekutiv, i zgjedhur nga ky bord, vepron si një grup këshillimi dhe vendos procedurat e ndryshme për shkollën.

Zyrtarët

Kryetar	Z. Piet Boekhoud, Hollande
Nënkryetarë	Z. Peter Ullinger, Gjermani
Sekretar	Rev. Imre Gusztin, Hungari

Komiteti Ekzekutiv

Kryetar	Mr. Piet Boekhoud
Nënkryetar	Mr. Peter Ullinger
Sekretar	Rev. Imre Gusztin
Rektor	Dr. Klaus Arnold (ex officio)
Drejtor i Rrethit të Euroazisë	Rev. Arthur Snijders (ex officio)
Koordinatori Edukimi për Euroazinë	Rev. Stéphane Tibi (ex officio)

Anëtarët e Bordit të Besuar në Fushat dhe Distriktet

Fusha e Europes Qendrore :

Shqiperi-Kosova, Bullgaria, Hungari, Rumania, Skandinavia

- Rev. Imre Gusztin, Hungari
- Rev. Ergest Biti, Shqiperi

Commonwealth I Fushes se Shteteve te Pavarura :

Rusia Veriore, Russia Jugore, Ukraina, Azia Qendrore, Armenia

- Rev. Sylvia Cortez-Masyuk, Ukraine
- Rev. Svetlana Kleshchar, Ukraine

Fusha e Europes Veriore:

Gjermani, Hollande, Poloni, Zvicer

- Rev. Martin Wahl, Gjermani
- Mr. Peter Ullinger, Gjermani
- Rev. Antonie Holleman, Hollande
- Mr. Piet Boekhoud, Hollade

Fusha Perendimore Mesdhetare

Azores, France, Itali, Portugali, Spanje

- Rev. João Pedro Pereira, Portugali
- Rev. Bruce McKellips, Portugali

Anetarë për Shkak të Detyrës (ex-officio)

Dr. Klaus Arnold, Rektor

Rev. Arthur Snijders, Drejtor i Rrethit të Euroazise

Rev. Stéphane Tibi, Koordinator i Edukimit për Euroazinë

II. POLITIKAT AKADEMIKE

A. PRANIMI DHE REGJISTRIMI

1.Kërkesat Hyrëse

Kolegji European Nazaretas, (KEN) është një shkollë profesionale. Në bazë të Klasifikimit të Standarteve Nderkombetare të Edukimit (KSNE) të Kombeve të Bashkuara, të Organizatave Shkencore dhe Kulturore (UNESCO) KEN ofron “cilikë të shkurter edukimi profesional” në nivele Bachelor. Në bazë të klasifikimit të KSNE në 1997, ky klasifikim është i nivelit 5b dhe në bazë të klasifikimit të ri të KSNE në 2011 është në nivele të 554. (Niveli 551 për programet e paakredituara.

Për programet e akredituara kërkesat për regjistrimin e edukimit për nivelin e parë të KEN është 18 vjeç dhe përfundimin e shkolles së mesme ose një shkollë profesionale. (KSNE Niveli 3A, 3B, ose niveli 344, 354, me klasifikimin e ri të KSNE të 2011) ose përfundimin e shkolles së mesme të përgjithshme ose një shkollë profesionale me kohë të pjeshme (niveli 4A, ose niveli 444 dhe 454 në klasifikimin e ri të KSNE të 2011)

Për programet e paakredituara, kërkesat e pranimit në edukim është moshë 18 vjeç dhe në përfundimin e arsimit të lartë apo të mesëm pa qasje të drejtpërdrejtë në arsimin terciar (ISCED niveli 3C dhe 4B, ose niveli 343, 353, 443 dhe 453 në një klasifikim të ri ISCED 2011).

Cdo qendër mesimore ka informacion specifik sesi të udhëzojë dhe të vendosë për shkollat specifike në vendet e tyre .

Për informacione specifike duke u bazuar tek KSNE dhe UNESCO referohuni në adresën e mëposhtme. <http://uis.unesco.org/en/topic/international-standard-classification-education-isced>

Përjashtime mund të bëhen në baza individuale të studentëve ende të regjistruar në nivel 3A ose 3B (ose niveli 344, 354) të arsimit të mesëm të cilët nuk kanë arritur ende ditëlindjen e tyre të 18-të. Këta studentë mund të regjistrohen në kurse hyrëse.

Studentet regjistrohen në kurse në gjuhë të tjera që mund të komunikojë, pasi e verifikon me koordinatorin e qendrës për të verifikuar aftësinë e gjuhës së folur.

2. Kërkesat e pranimit jo zyrtare.

Kërkesat e pranimit jozyrë janë për aplikantët që duan të behen pjesë e programit të KEN-it, janë 28 vjeçare, dhe nuk kanë përfunduar shkollën e mesme ose ekuivalentet e saj, ose nuk mund të marrin diplomën. Çdo kandidat pas 28 vjeç, përpqen për të qene të shkëlqyer, dhe duhet të mbarojnë edukimin e saj/tij ose ekuivalentet e saj para se të fillojë KEN. Çdo pritshmeri për këtë procedurë duhet të rekomandohet me shkrim nga Qendra Mesimore për Skuadrën e Drejtimit.

Përtej dokumenteve të zakonshme të pranimit nevojiten (aplikimi, deklarata e synimit, Reference e pastorit/mbikqyresit distriktual), për “Jozyrtaret” pranimit I aplikantit do të regjistrohet si “I padiplomuar” studentët që për periudhën provuese, që në hapat e mëpasshëm duhet të përfundojë :

- 1) Studenti duhet të marrë dhe të kalojë ACP1000 “Hyryen në KEN” dhe dy nga kurset e hyryes : ACP11 Hyrye e Afesite Akadematike Skills, BIB11 Hyrye në Dhjaten e Vjeter, BIB12 Hyrye në Dhjaten e Re, MIS11 Misioni I Përfundimit dhe Kisha dhe THE11 Hyrye në Teologji.
- 2) Studenti do të ketë një mentor personal (nga Qendra Mesimore), I cili do të asistojë në veshitësite akademike ose nevojat që do të hasin.
- 3) Pas periudhës së provës (përfundimit të tre kurseve), Koordinatori I Qendrës Mesimore, do të shkruajë një përmbledhje të çfarë ka bërë studentin në studimet e tij/saj dhe ia dërgon skuadrës drejtuese. Skuadra e Drejtimit merr një vendim final ose nëse periudha e provës është e plotë, duhet të zgjatet, ose studentin nuk është më në gjendje të marrë klasë. Studentin nuk është i lejuar të marrë kurse të tjera pas këtyre tre kurseve, pasi vlerësimi bëhet nga Ekipi i Liderit.

3. Përgjegjësitë e Studentëve.

Administrata dhe fakulteti i Kolegjit Europian Nazaretas përpqen t'i qartësojnë dhe t'i këshillojnë studentët në mënyrë të qëndrueshme përse u përket kërkesave për diplomimin dhe progresin e tyre në plotësimin e këtyre kërkesave. Megjithatë, pjesë e zhvillimit personal të studentëve, është njohja dhe miratimi i përgjegjësitë të tyre në plotësimin e të gjitha kërkesave të diplomimit. *Studenti pritët të marrë iniciativën dhe të ndjekë të gjitha kërkesat dhe detajet e programit akademik.* Çdo pyetje që kanë studentët përse i përket progresit të tij ose të saj, ose kurset e studimit, duhet të drejtohen së pari tek Kryesekretaria ose të Koordinatorit i Qendrës Mësimore më të afërt dhe në fund tek Dekani i EuNC-së.

4. Zbatimi i Katalogut

Studentët do të diplomohen duke përmbushur kërkesat e katalogut në fuqi, në fillim të vitit të tyre të parë, duhet të plotësojnë limitet e studimeve që gjenden në seksionin 6. Programet e kerkuara nga agjensi të jashtme aplikohen sapo të aprovohen. Në qoftë se karriera akademike e studentit është ndërprerë për më shumë se pesë vjet, studentit duhet të diplomohet nën programin e katalogut aktual. Rregulloret zbatohen ndaj të gjithë studentët që në momentin e botimit të katalogut.

5. Transferimi i Krediteve

EuNC-ja duhet të ketë një kopje të dëftesës zyrtare direkt nga institucioni arsimor i mëparshëm i frekuentuar për vlerësimin. Një maksimum prej 49% i numrit të kërkuar të krediteve mund të transferohet në çdo program.

Studentët që duan të transferojnë kredi të pranueshme nga EuNC duhet të paraqesin një dëftesë zyrtare nga shkolla e tyre e mëparshme Kryesekretares ose Koordinatorit të Qendrës Mësimore, duke specifikuar kurset që duhet të vlerësohen për transferimin e krediteve. Nëse është e nevojshme, informacione të mëtejshme mbi shkollën dhe të kurset duhet të jepen kështu që KEN mund të bëjë një vlerësim të saktë mbi transferimin e krediteve.

Udhëzimet e përgjithshme

- KEN pranon transferimin e vetëm atyre lëndëve që janë në përputhje me një nga kurset e listuara në Katalogun Akademik të KEN-it.
- Notat e marra nga lëndët e transferuara nuk do të përfshihen në GPA e studentit.
- Në situata të caktuara, KEN mund të jap studentit kredite për studime paraprake.
- Kredite nga programet e shkollave të mesme (KSNE 3A, 3B, ose 344 dhe 354) NUK do të pranohen në asnjë program.

6. Studimet e zgjatura

Studentet e regjistruar ne nje program do te pranohen te marrin minimumin 15 kredite ne nje vit akademik. Per programet e certifikatave ka nje maksimum per 4 vitesh per te perfunduar studimet. Ndersa per programet e diplomimit ka nje maksimum prej 8 vitesh per te perfunduar programin.

Studentet duhet te regjistrohen zyrtarisht ne program para se te perfundojne nje te treten e synimit te programit. Pas kesaj pa nje deklarete te synimit, studenti është i papërshtatshëm për t'u diplomuar me një program, por mund të vazhdojë të marrë kurse individuale. Pas regjistrimit ne nje nga programet, studentet duhet te marrin ngarkesën e kerkuar akademike.(shiko II. B. 1.).

7. Qartësimi i Diplomimit

Çdo kandidat për diplomimë është përgjegjës për përmbushjen e të gjitha kërkesave për diplomim. Dekani miraton kurset të dizenuar për të plotësuar kërkesat e programit.

Kryesekretaria rishikon nëse kandidati për diplomim përmbush kërkesat e mëposhtme:

1. Duhet të përmbushen të gjitha nivelet e kërkesave për programe specifike, siç edhe janë listuar në katalog.
2. Duhet të shlyhen të gjitha detyrimet financiare.
3. Koordinatori i Qendrës Mësimore, Koordinatori për Edukim i Zonës, dhe Dekani Akademik duhet të japin shpjegime të qarta cdo studenti që po mbaron programin mësimor.

Nuk do të jepet asnjë certifikatë ose diplomë deri sa të përmbushen të gjitha kërkesat e mësipërme.

8. Përcaktimet e Vitit Shkollor

Viti shkollor i KEN-it fillon në Shtator dhe mbaron në Gusht të vitit shkollor në vazhdim.

B. Të mësuarit për kursin

1. Peshë Akademike

Të gjitha qëndrat mësimore të KEN-it ofrojnë programe me kohë të pjesshme. Ngarkesës vjetore akademike të një studenti ndryshon dhe varet nga numri i kurseve të ofruara nga qendrat e mësimit dhe / ose të marra nga studentët. Për studentët e regjistruar në një nga programet e ngarkesës vjetore do të jetë midis 15 dhe 30 Kredite.

Sipas kriterëve të sistemit të Bolonjës, ngarkesa akademike mesatare për një student me kohë të plotë gjatë një viti shkollor është 60 Kredite (1500 -1800 ore mesimore per student) Një Kreditet është i barabartë me 30 orë mësimi për studentin.

2. Integriteti Akademik

Te gjithë programet dhe materialet e kursit janë prona e KEN-it. Institucione të tjera mund të përdorin material dhe komponente të kursit pasi kanë marrë leje nga Rektori i KEN-it dhe duke vënë në dijeni KEN-in.

KEN është perkushtuar në përgatitjen e programeve që ofrohen studenteve. Kolegji për qëllime vlerësimi mund dhe/ose të akreditimit mund të përdoret çdo detyrë të caktuar për këto kurse. Nëse studenti nuk dëshiron që detyrat e tyre të përdoren në këtë mënyrë, ata duhet të bëjnë një kërkesë me shkrim mbi ndikimet e saj, dhe t'i a dorëzojnë mesuesit.

Pandershmeria akademike është një shkelje serioze etike e integritetit akademik. Dënimi minimal për pandershmerinë akademike do të jetë dështimi i caktimit. Në diskrecionin e fakultetit mund të zbatohen masa më të rrepta, duke përfshirë dështimin e kursit, provën akademike ose pezullimin akademik.

3. Pronë intelektuale

Te gjithë programet dhe materialet e kursit janë prona e KEN-it. Institucione të tjera mund të përdorin material dhe komponente të kursit pasi kanë marrë leje nga Rektori i KEN-it dhe duke vënë në dijeni KEN-in.

KEN është perkushtuar përgatitjen e programeve që ofrohen studenteve Kolegji për qëllime vlerësimi mund të përdoret çdo detyrë të caktuar për këto kurse. Nëse student nuk dëshiron që detyrat e tyre të përdoren në këtë mënyrë, ata duhet të bëjnë një kërkesë me shkrim mbi ndikimet e saj, dhe t'i a dorëzojnë mesuesit.

4. Aftësitë gjuhësore.

Një rregull i përgjithshëm për të gjithë kurset është që 10% e notes së detyrave të shkruara (esetë, rishikimet) do të përcaktohen në bazë të gabimeve gramatikore dhe drejtshkrimore, si dhe aftësisë për tu shprehur në mënyre të qartë.

5. Pjesëmarrja në mësim.

Studentët duhet të ndjekin të gjitha orët e mësimit, përveç rasteve kur kanë sëmundje serioze ose për situata të tjera të pashmangshme. Ata janë përgjegjës ndaj profesorit në përmbushjen e të gjitha kërkesave të kursit.

Mosprania mbi 10% në orët e mësimit do të denohet sipas planit mesimor të çdo klase individuale. Nëse student mungon 25% ose më shumë në orët e mësimit, për çdo lloj arsye, do të hiqet nga kursi dhe do të vlerësohet me notën "W". Ky rregull do të aplikohet në të gjitha situatat, përfshirë këtu edhe qellimet e pashmangshme.

Per klasat online, rregullat të veçantë do të shfaqen në program. Komiteti i QM bazohet në peticionin e shkruar me shkrim mund të bëjë një shpjegim për këtë rast. Anëtarët e fakultetit për çdo klase janë përgjegjës duke përfshirë të gjitha politikat e vlerësimit në klase sipas programit.

6. Rregullat për dorëzimin e detyrave me vonese.

Çdo profesor duhet të formuljë në planin mesimor rregullat për detyrat që dorëzohen me vonese. Rregulli duhet të përvaktojë denimin për çdo ditë që detyrat dorëzohen me vonese Brenda një numri të caktuar ditësh mbas të cilave nuk do të pronojnë me detyrat dhe nuk do të japin me piket. Profesori është i lire të japë më shumë kohë studentëve nëse ata kanë arsye të forta.

7. Vlerësimet e kursit.

Pjesë e kërkesave të çdo kursi është që studenti të përfundojë vlerësimin mbi kursin e bërë. Kjo është e rëndësishme për vlerësimin e vazhdueshëm që EuNC i bën vetes. Për disa qendra mesimore, studentët që nuk kanë plotësuar vlerësimet e tyre natyrisht nuk do të jetë në gjendje të shikojnë notat e tyre përfundimtare në Sonis.

8. Pëfundimi I kursit.

- a. Oret e Studimit. Shtrirja e kursit të KEN duhet të planifikohet në atë mënyrë që, studentët të kenë një ngarkesë javore 12-15 orë duke përfshirë edhe Kohën e seksionit. Mjetet që do të zhvillojnë këto ndihmojnë mesuesin dhe koordinatorin e qendres të përdorin gjatë kohës së shtrirjes në kohë që duhet të jepet për çdo kurs në varësi të numrit të krediteve .
- b. Kursi në klasë. Këto janë kurset që ofrohen në konsistencë të qendres mesimore si një seri e seksioneve të klases ku jepet mësim në një qendër me një mesues dhe të gjithë studentët janë prezente në QM. Përgjithësisht, seksionet në klasë, për këto kurse, janë duke u mbajtur në mënyrë intensive, për një periudhë kohore 4 – 14 ditë, me paradhë pas seksionit të detyrave të klases, ose të ndara këto me një interval të rregullt në një periudhë gjatë kohës. Kur planifikohet për dhënie të një kursi për t'u dhënë në seksionin e klases, mesuesi dhe QM duhet të planifikojë për të mos dhënë maksimumin e 6 orëve të seksionit në klasë për një ditë. Këto kurse mund të behen online ose me videokonferencë, duke u udhëzuar dhe i asistuar studentët me para dhe pas seksionit të detyrave të klases.
- c. Kurset Online. Ky është një kurs që ofrohet ermes interentit pa asnjë seksion në klasë në një vend të caktuar ose përmes video Konferencës..
- d. Kurset që përdorin video konferencën. Në kurset me videokonferencë, seksionet e klases mbahen me mesuesin dhe studentët që janë në një ose në shpesh vendndodhje duke përdorur video cilesore dhe aparate zeri (Spiker). Këto kurse mund të kenë një komponent online për të drejtuar dhe asistuar studentët me detyrat para dhe pas seksionit të klases.
- e. Kurset Hibride. Këto kurse mund të përdoren në një nga shumë mënyrat e mesimdhënies (në-Klasë, online, ose video Konferencat.)
- f. Studimet Direkte. Studimet direkte janë kurse individuale që ofrohen për studentët të vecantë. Plani i kursit është i drejtuar nga anëtarët e fakultetit dhe përfshijnë studimet e pavarura. Maksimumi i numrit të krediteve lejon studimet direkte që të jenë normalisht 15 ECTS. Të gjitha kurset e studimeve direkte kanë një prapashetë “D.”

C. Notat.

1. Sistemi i notave

Puna akademike e studentëve vlerësohet në përputhje me sistemin e listuar më poshtë. Shumica e detyrave kanë një rubrikë të veçantë vlerësimi e cila është e specifikuar në planin mësimor të kursit.

PERQINDJA	SHKRONJA E NOTES	PIKET E NOTES	SHPJEGIMI
97-100%	A+	4.0	PUNE E SHKELQYER. Puna e studentit përmbush pritjet e detyrës me një zotërim të shkëlqyer të materialit dhe pa asnjë dobësi.
93-96%	A	4.0	PUNE shumë E MIRE. Puna e studentit përmbush pritjet e detyrës me një zotërim të plote të materialit dhe nuk ka dobësi të konsiderueshme.
90-92%	A-	3.7	
87-89%	B+	3.3	PUNE E MIRE. Puna e studentit përmbush pritjet e detyrës me një zotërim të mirë të materialit dhe ka dobësi të vogla.
83-86%	B	3.0	
80-82%	B-	2.7	
77-79%	C+	2.3	PUNE E KUJDESESHME. Puna e studentit përmbush pritjet e detyrës por ka disa dobësi të dukshme.
73-76%	C	2.0	
70-72%	C-	1.7	
67-69%	D+	1.3	PUNE E DOBET. Puna e studentit përmbush pritjet minimale të detyrës por ka dobësi të konsiderueshme.
63-66%	D	1.0	
60-62%	D-	0.7	
0-59%	F	0.0	NGELJE NE KLASE. Mangësitë e punës së studentit nuk e justifikojnë notën kaluese.

Nota e "F" tregon dështimin e lëndës dhe kërkon një përsëritje të kënaqshme të kursit para se të jepet krediti.

Mesatarja e pikëve të notës së një studentit përcaktohet duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të pikeve të klasës së mbaruar me sukses me numrin i përgjithshëm të krediteve ECTS të marra në një term. Kurse të cilat janë transferuar nga një program tjetër, ose kurse me një notë "U" (i pakenaqshem)ose "S" (i kenaqshem) nuk merren parasysh në përcaktimin e mesatares së pikëve së notës.

2. Orët si dëgjues.

Nëse është bërë pagesa e regjistrimit në shkollë, studentët mund të regjistrohen në shumicën e kurseve në çdo semestër si një dëgjues. Individit që është dëgjues në një kurs nuk i lejohet të marrë provimin ose të fitojë kredi përveçse duke e marr kursin më vonë, duke bërë regjistrimin e duhur dhe duke përmbushur kërkesat për kredi. Një "AU" (Dëgjues) do të shfaqet në raportin e notave dhe dëftesë. Studentët që janë dëgjues në

klasa duhet të frekuentojnë 2/3 e sesioneve të orëve para se kursi të regjistrohet në dëftesë. Dështimi për të marrë pjesë në dy të tretat e klasave nuk do të rezultojë si pjesë e dëftesës, dhe nuk do të kërkojë rimbursim të tarifave administrative.

3. Tërheqja, largimi nga kursi.

Studentët mund të tërhiqen nga një kurs me një “W” (Tërheqje), kur ata kanë marrë pjesë në më pak se 55% të gjithë kursit, duke numëruar që nga dita zyrtare e fillimit të kursit të gjëndur në programin mësimor. “WF” (Tërheqje me ngelje në klasë) regjistrohen kur studenti ka një notë ngelëse në momentin që tërhiqet. Studentët që mendojnë se është e nevojshme të tërhiqen nga një kurs i caktuar duhet të flasin me profesorin dhe Koordinatorin e Qendrës së Mësimore.

Nje student mund te rimbursohet nga terheqja e kursit duke u bazuar ne tabelen e fq. 28.

4. Ngelja – Opsioni I Përsëritjes së Klasës.

Studentët që kanë marrë si notë një D ose më pak kanë të drejtën ta përsërisin kursin. Nëse studentët dëshirojnë ta përsërisin kursin, ata duhet t'i drejtojnë një petition Dekanit Akademik nëpërmjet Koordinatorit të Qendrës Mësimore. Dhe si notë do të shënohet vetëm nota që është marrë pasi është përsëritur kursi, kështu që nota që ishte marrë më fillim do të ndryshohet me shkronjën “P” (Përsëritje). Notat “W” dhe “I” nuk konsiderohen si nota zëvendësuese.

5. Nota jo e Plotë.

Nota “I” (jo e Plotë) tregon një detyrë jo të plotë dhe i vendoset një studenti, i cili për arsye të mira dhe të forta nuk ka bërë një pjesë të detyrës ndërsa ka bërë pjesën tjetër të detyrës në mënyrë të kënaqshme. Detyra jo e plotë duhet të plotësohet brenda kohës që ka dhënë mësuesi dhe nuk duhet të dorëzohet mbas 3 muajve që nga data që u dha detyra e paplotë. Në rastin e një detyre jo të plotë, mësuesi dhe studentët duhet të plotësojnë një Formular të Notës së Papolotë, ata duhet të vendosin firmat në mënyrë që të dokumentojnë marrëveshjen, në mënyrë që të vendosin notën përfundimtare në rast se nuk janë respektuar kërkesat. Mësuesi do t'ia dorëzojë këtë formular Koordinatorit të Qendrës së Mësimimit dhe Kryesekretarisë.

6. Pezullimi Akademik.

Që të vazhdohet regjistrimi për në një nga program e Certifikatave ose diplome të KEN,

studenti duhet të vazhdojë të bëjë progres të kënaqshëm në arritjen e objektivave mësimore.

Çdo student për të cilin Pikët Mesatare të Akumuluar në fund të çdo termi bien nën standardet minimale 1.5 do të vendoset nën povë. Kështu, studentit do të marre një mbikqyrje speciale, dhe do të mentorohet me shume ngushtesisht për të përmirësuar performancën e tij/saj akademike. Statusi i provës do të përcaktohet çdo vit nga Sekretari në bazë të GPA të studentëve. Atij ose asaj mund të kërkohet gjithashtu të rimarrë kurse të caktuara.

Studentet duhet të mbajnë në mendje se pa një rritje specifike të GPA nuk mund të jete një kerekese e të diplomuarit nga EuNC, kerkesa e hyrjes për studimet e tjera në shkollë të tjera për të vazhduar studimet e tjera kerkohet një minimum GPA. Për këto arsye, mbajtja e një GPA të mirë dhe notat e mira në një kurs sipas bazës së kurseve inkurajohet.

7. Çmimet e Nderit.

Kolegji European Nazaretas aplikon çmimet e nderit të mëposhtme në Diplomen e Shërbesës së Krishterë, duke njohur punën akademike të diplomuesëve të tij:

Summa Cum Laude	Mesatarja e Pikëve të Notave 33.90 and 4.00
Magna Cum Laude	Mesatarja e Pikëve të Notave 33.70 and 3.89
Cum Laude	Mesatarja e Pikëve të Notave 33.50 and 3.69

8. Dëftesa.

Studentët kanë të drejtë të marrin një kopje të dëftesës zyrtare falas dhe një tjetër jozyrtare që mund të jepet studentit në fund të edukimit me KEN. Tarifa prej 7 Euro është vendosur për kopjen e dytë. Kopjet të tjera jepen vetëm nëse të gjitha detyrimet financiare janë përmbushur dhe nëse studentët kanë bërë kërkesën e tyre me shkrim për ta patur këtë kopje.

D. POLITIKAT AKADEMIKE DHE PROCEDURAT.

Procesi i mëposhtem është për të siguruar një mekanizëm për studentet për të marre vendime që janë të lidhura me punën e tyre akademike.

1. Se pari studentet duhet të diskutojnë mbi çështjen me anetaret e fakultetit ose me administratorin me shprehje që ky diskutim mund të sjellë ndonjë zgjidhje.

2. Nëse nuk jep ndonjë zgjidhje të kënaqshme, ose është një çështje që nuk mund të adresohet në anetari fakulteti, duhet të përhapet si një çështje akademike, limitimi i gjuhëve, ndjeshmeria e të tjerë. Studenti duhet të komunikojë me koordinatorin ose me administratorin e qendrës mbi këtë çështje.
3. Nëse ky takim nuk mund ta zgjidhë perseri çështjen, studenti mund të bëjë një kërkesë formale drejtuar rektorit. Kërkesa duhet të shkruhet në gjuhën e studentit dhe duhet të përmbajë:
 - a. EMRI I Studentit.
 - b. QENDRA MESIMORE
 - c. Personat e përfshirë
 - d. Data e incidentit
 - e. Përshkrimin e incidentit që e shqetëson nderhyrja e mëparëshme,
 - f. ndërmjetësimi që nuk e ka kënaqur studentin.
 - g. Mbrojtja e aksionit/arsyeja që studenti ndihet që ky aksion nuk është i drejtë.
 - h. Konfirmimi i takimit dhe detajet e hollësishme mbi takimin me anetaret e fakultetit ose/dhe koordinatorin ose administratorin e qendrës mesimore.

Studentet inkurajohen të bëjnë ankesat fillestare brenda 30 ditëve pasi problemi ka ndodhur. Ankesat e vonuara të një çështjeje mund të ndodhin jo më vonë se 30 ditë pas vendimit të dhënë.

Do të ketë një rishikim fillestar të vendimit brenda 30 ditëve për marrjen e një vendimi të rëndë ose të kërkohet informacion. Një vendim formal do të jepet jo më vonë se 30 ditë pasi të jepet vendimi për çdo nivel.

III. FINANCAT

Kolegji Evropian Nazaretas nuk ka te njejtat tarifa për të gjithë studentët. Meqënëse shkolla është e subvencionuar nga Kisha e Nazaretasit për një detyrë specifike si përgatitja e shërbëtorëve të Perëndisë në Evropë dhe shtetet e ish – Bashkimit Sovjetik, studentët jashtë këtyre territoreve do të paguajnë taksa më të larta që pasqyrojnë koston e vërtete të shkollës. Studentët nga qendra mësimore të ndryshme do të paguajnë tarifa të ndryshme të cilat janë bazuar në situatën ekonomike dhe fazën e zhvillimit të distriktit të Kishës së Nazaretasit në shtetet përkatëse.

Tarifa e përgjithshme është e përbërë nga tarifa e kursit dhe tarifa e administrimit. Tarifa e kursit shkon për të mbuluar shpenzimet e qendrës mësimore, ndërsa tarifa e administrimit kontribuon në shpenzimet e administratës qendrore që siguron të gjitha shërbimet akademike për qendrën mësimore.

Tarifat janë të bazuara në qendrën mësimore ku studenti është regjistruar. Qendrat mësimore të KEN janë të ndara si mëposhtë:

- E3 Studentet në qendren mesimore në Itali.
- E4 Studentet në qendren mesimore në Portugali
- E5 Studentet në qendren mesimore në France dhe Hungari
- E6 Studentet në qendren mesimore në Albania-Kosova, Bulgaria, DC-Kroacia dhe Romania.
- E7 Studentet në qendren mesimore në Armenia
- E8 Studentet në qendren mesimore në Spain
- E9 Studentet në qendren mesimore në Gjermani, Hollande, Skandinavia dhe Digital Campus
- EA Studentet në qendren mesimore në Asine Qendrore, Russia and Ukraine
- N2 Studentet në qendren mesimore në CIS që marrin kurse në një nga qendrat mesimore.

KEN ka disa fonde bursash të gatshme në shumicën e qendrave mësimore për studentët që nuk kanë mundësi të paguajnë taksat e shkollës. Koordinator i Qendrës Mësimore mund të japë më shumë informacione.

Më poshtë janë listuar tarifat e aplikuara në bazë të zonës përkatëse:

Zona	Tarifa e Aplikimit	Tarifa e kursit për Kredit ECTS	Tarifa e përgjithshme për Kredit	Bursat1	Taksa totale për Kredit
E3	€23,00	€35,00	€3,00	€10,00	€28,00
E4	€23,00	€35,00	€3,00	€16,00	€22,00

E5	€23,00	€25,00	€3,00	€11,00	€17,00
E6	€23,00	€25,00	€3,00	€18,00	€10,00
E7	€23,00	€22,00	€3,00	€19,00	€6,00
E8	€23,00	€25,00	€3,00	€15,00	€13,00
E9	€23,00	€45,00	€3,00	€0,00	€48,00
EA	€23,00	€22,00	€3,00	€18,00	€7,00
N2	€23,00	€129,00	€3,00	€0,00	€132,00

Bursat1 bazohen ne vleresimin e notave ne disa qendra mesimore dhe do ti jepen te gjitha qendrave

- Studentët që janë vetëm për dëgjimin e lëndës paguajnë vetëm gjysmën (50%) e taksës totale për kredit
- Studentët që marrin kurse online nëpërmjet KEN dhe shfrytezojne bashkpunimin me Kolegjit Biblik Nazaretas (NBC) paguajnë taksën e parashikuar për zonën E9.
- Studentët që tërhiqen nga kursi, apo që ndryshojnë nga regjistrimi për të marrë lënden për kredite në regjistrim për të qënë dëgjues, pasi kursi ka filluar, mund të përfitojnë një rimbursim total apo parcial. Në rast tërheqjeje nga kursi, është përgjegjesi e studentit që të lajmërojë Kordinatorin e Qendrës Mësimore apo Administratorin. Rimbursimi i lekëve është i bazuar në përqindjen e kursit të mbaruar (i llogaritur në bazë të fillimit dhe mbarimit të lëndës ashtu sic përcaktuar nga programi mësimor) në bazë të listës së mëposhtme:
 - o 0-10% i kursit është kompletuar - 100% ribursim
 - o 11-25% i kursit është kompletuar - 50% ribursim
 - o 26% i kursit është kompletuar – nuk a ribursim.
- Studentët që kërkojnë një dëftesë duhet të parapaguajnë €7.

IV. PRITJA E REZULTATEVE DUKUESE.

Njëzet e tre rezultatet e mëposhtme përshkruajnë atë që KEN-i do që të përmbushë në programet e tij edukuese. Ato ndahen në katër rezultate të ndryshme lidhur me njohurinë, kompetencat, tiparet e karakterit personal dhe ndjeshmërinë për probleme kontekstuale, të domosdoshme për shërbesë efektive.

Kurset individuale të ofruara nga EuNC-ja kontribuojnë për të përmbushur disa nga rezultatet edukative siç janë treguar në planin mësimor.

Përmbajtja

Njohuri mbi përmbajtjen e Dhiatës së Vjetër dhe të Re, teologjia e besimit të Krishterë, Historia dhe Misioni i Kishës janë thelbësore për shërbesën. Njohuri mbi interpretimin e Shkrimeve të Shenjta, Doktrinën e Shenjtërisë, karakteristikat tona Uesliane dhe Historia dhe Politika e Kishës së Nazaretit, duhet të përfshihen në këto kurse.

- CN1 Bibla. Studentët do të mësojnë përmbajtjen dhe teologjinë e Dhiatës së Vjetër dhe të Re, sfondin e tij historik dhe llojet e ndryshme të literaturës si dhe problemet kyçe të hermenautikës.
- CN2 Teologji. Studentët do të mësojnë temat e ndryshme të Teologjisë së Krishterë, historinë e saj dhe specifisht teologjinë shenjtëruese Uesliane dhe Doktrinën e Kishës së Nazaretit.
- CN3 Kisha. Studentët do të mësojnë Historinë e Kishës dhe kulturën rrethuese dhe do të kenë një kuptim të qartë të / dhe vizionit të kishës.
- CN4 Shërbesa. Studentët do të kenë njohuri specifike të domosdoshme për shërbesën efektive në fusha të ndryshme të Misionit të Kishës.
- CN5 Njerezit. Studentët do të kenë njohuri specifike që do t'i instruktojnë ata që të punojnë me njerëz në rrethana të ndryshme dhe t'i përgatisin ata që të edukojnë komunitetin.
- CN6 Literatura Shkencore. Studentët do të zhvillojnë një perspektivë informuese dhe respekt për krijimin e rendit për përdorimin e metodave të kërkimit shkencor për ta eksploruar atë.

Kompetenca

Aftësitë në komunikimin me gojë dhe me shkrim, menaxhimi dhe udhëheqja, financa dhe të menduarit analitik janë gjithashtu thelbësore për shërbesën. Përveç edukimit të përgjithshëm në këto fusha kurset që sigurojnë aftësi në predikim, kujdes dhe këshillim pastoral, adhurim, ungjillizim efektiv, edukimi i krishterë dhe administrimi i kishës duhet të përfshihen. Diplomimi kërkon partneritetin mes shkolles dhe një kishë lokale për t'i drejtuar studentët në praktikën e shërbesës dhe zhvillimin e kompetencave.

- CP1 Interpretimi. Studentët do të jenë në gjendje të interpretojnë Shkrimet e Shenjta në mënyra interpretuese dhe teologjike dhe të jenë në gjendje t'i zbatojnë ato.

- CP2 Komunikimi. Studentët do të jenë në gjendje të komunikojnë qartë me njerëzit në mënyra dhe ambiente të ndryshme dhe të jenë në gjendje që të marrin mesazhin e të tjerëve.
- CP3 Udheheqja. Studentët do të jenë në gjendje të udhëheqin njerëzit më afër Perëndisë, të udhëheqin kishën në një shërbesë më frutdhënëse, dhe të aftë për menaxhimin organizativë dhe personal.
- CP4 Shërbesa. Studentët do të jenë në gjendje t'u shërbejnë individëve dhe grupeve që kanë nevoja të ndryshme dhe të sigurojnë kujdes pastoral për këto nevoja.
- CP5 Analize. . Studentët do të jenë në gjendje të analizojnë dhe adresojnë situatat aktuale në kishë dhe në shoqëri në një mënyrë historike, teologjike dhe biblike.
- CP6 Te menduarit Kritik. Studentët do të zhvillojnë aftësinë për të përcaktuar vlefshmërinë dhe arsyetimin nëpërmjet ekzaminimit të informacionit, argumentimit dhe eksperiencës.

Karakteri

Rritja personale në karakterin, etikën, natyrën shpirtërore dhe marrëdhëniet personale dhe familjare janë jetike për shërbesën. Duhet të përfshihen kurset që adresojnë sferat e etikave të krishtera, formimit shpirtëror, zhvillimit njerëzor, individin e shërbesës, dinamikat e martesës dhe familjes.

- CH1 Integrimi. Studentët do të jene në gjendje të përdorin njohuritë që ata kanë marrë ne jetët e tyre personale
- CH2 Transformimi. Studentët do të kenë rritje në kërkimin e tyre për një jetë të shenjtë në të gjitha dimensionet e ndryshme të jetës së përditshme dhe personale
- CH3 Angazhimi. Studentët do të angazhohen që të vendosin veten në dispozicion si shërbëtor të misionit të Perëndisë në këtë botë dhe kryerjen e shërbesave të tyre specifike
- CH4 Natyra Shpirtërore. Studentët do të zhyten në disiplinat shpirtërore si burim për shërbesën e tyre personale.
- CH5 Vete - kuptimi. Studentët do të pranojnë veten e tyre si persona të vlefshëm dhe do të zhvillojnë zakone jetese që janë mendërisht dhe fizikisht të shëndetshme.

Konteksti

Shërbyesi duhet të kuptojë të dyja si kontekstin historik ashtu edhe atë bashkëkohor dhe të interpretojë botë-shikimin dhe ambientin social të kulturës ku kisha është dëshmitare. Duhet të përfshihen kurse që adresojnë shqetësimet e antropologjisë dhe sociologjisë, komunikimin ndërmjet kulturave, misionit, dhe studimeve sociale.

- CT1 Rendesia. Studentët do të jene në gjendje të komunikojnë Ungjillin në mënyra të përshtatshme për njerëzit në kontekste të caktuara duke përdorur principet e shëndosha hermenautike.

- CT2 Pergjegjesite kulturore. Studentët do të kenë ndjeshmëri mbi kontekstet e ndryshme kulturore dhe do të jenë në gjendje të shërbejnë në mënyrë efektive brënda dhe midis tyre.
- CT3 Administrimi. Studentët do të kenë një këndvështrim të shenjtë në përgjegjësitë e ndryshme që ka kisha në këtë botë dhe njerëzit e saj.
- CT4 Integrimi.. Studentët do të pajisen me aftësinë e integritetit të besimit të krishterë në të gjitha fushat e jetës nga perspektiva teologjike Uesliane.
- CT5 Kultura dhe Shoqëria. Studentët do të kenë njohuri të përgjithshme mbi situatën shoqërore dhe politike të shtetit të tyre, si dhe historinë dhe kulturën që ata ndajnë me shtetet dhe rajonet fqinje.
- CT6 Pergjegjesite Sociale. Studentët do të jenë qytetarë të informuar, interesuar dhe të përfshirë në botën që i rrethon.

V. PLANI MESIMOR I KEN.

A. HYRJJE

KEN ofron një plan mësimor të vetëm me varicione që u përshtaten kontekstit ku zhvillohet mësimi. Ky plan mësimor ofrohet në dy nivele akademike të ndryshme: Kolegji për Kredite për Kishën dhe Kolegji për Kredite Akademike. KEN ofron katër programe të ndryshme: dy për secilin nga tipologjitë e krediteve.

B. KORNIZA E KURRIKULËS.

Plani mesimor i EuNCs është i përbërë pesë togje. Te gjithë kurset për programet e kursit janë ndare në një nga këto fusha. Çdo program është strukturuar sipas ketyre pesë togjeve, por nuk gjendet në adresat e togjeve. Te gjithë urset janë të ofruara sipas ne vendet e tyre në program, që provon një koherencë të caktuar në kurrikulë.

C. PERSHKRIMI NE PESE TOGJEVE.

T Mënyra se si janë lidhur nëntë togjet në strukturën e planit mësimor reflekton atë që EuNC-ja sheh si misionin e tij primar; edukimin e shërbyesëve. Në përshkrimin e togjeve më poshtë, numri i kërkuar i ECTS, krediteve për çdo program është listuar gjithashtu. Këto janë kërkesat minimale për çdo program në çdo pozicion.

TOGU A. Bibla (Gjithë numrat e kurseve që fillojnë me BIB)

Burimi themelor që informon pamjen tonë në Zotin, kishën, botën dhe shërbesën është Bibla. Prandaj studentët duhet të kenë themelet në Bibël për të marrë drejtim dhe frymëzimin.

Çertifikata ose Kualifikimi i Formimit Shpirtëror : 15 ECTS, Kredite
Diploma ose Kualifikimi i Shërbesës së Krishterë: 25 ECTS, Kredite

Togu B. Teologji, Tradite, dhe Identitetet (Të gjithë numrat e kurseve fillojnë me THE në anglisht)

Teologjia jonë rrjedh nga Bibla, e shtuar në të informacioni nga tradita, arsyeja dhe eksperiencia (katërkëndshi Ueslian). Është teologjia jonë karakteristike Uesliane që siguron identitetet dhe përshkruan se kush jemi ne si kishë.

Çertifikata ose Kualifikimi i Formimit Shpirtëror : 6 ECTS, Kredite
Diploma ose Kualifikimi i Shërbesës së Krishterë: 23 ECTS, Kredite

Togu C. Misioni i Perëndisë dhe Kisha, Shërbesa. (Të gjithë numrat e kurseve fillojnë me MIS në anglisht)

Qendra e planit mësimor është kuptimi biblik i zemrës së Perëndisë dhe misionit të tij në botë. Mënyra se si ne e kuptojmë kishën dhe jetët tona si një thirrje duhet të bazohet nga i kuptuari misiologjike (misionare) dhe besimtarët duhet të gjejnë vendin e tyre në punën misionare të Perëndisë me anë të kishës si trup i Krishtit.

Çertifikata ose Kualifikimi i Formimit Shpirtëror : 15 ECTS, Kredite
Diploma ose Kualifikimi i Shërbesës së Krishterë: 23 ECTS, Kredite

Togu D. Specializimet në Shërbesë (Të gjithë numrat e kurseve fillojnë me MIN dhe pak me SOC në anglisht)

Gjatë studimit të shërbesave thelbësore të kishës dhe marrjes së njohurive të përshtatshme, studentët do të eksplorojnë shërbesat specifike ose rolin e shërbesës dhe zhvillimin e kompetencave të duhura. Kurset muzikore shihen si mbështetëse të shërbesave të kishës dhe kanë vendin e tyre në këtë tog.

Çertifikata ose Kualifikimi i Formimit Shpirtëror : 4 ECTS, Kredite (3 tre prej te cilave jane te zgjedhurane opsionin e togut)
Diploma ose Kualifikimi i Shërbesës së Krishterë: 21 ECTS, Kredite (10 prej te cilave jane zgjedhur ne opsionin e togut)

Togu E. Aftesite Akademike dhe Studime te Pergjithshme (Te gjithë kurset qe fillojne me numrin ACP, disa me GEN dhe pak me SOC)

Studentët duhet të zotërojnë kompetencat që do t'i bëjnë ata të suksesshëm në studimet e tyre. Ata gjithashtu kanë nevojë të tregojnë se janë në gjendje që të integrojnë ata që mësojnë në një këndvështrim të përgjithshëm.

Çertifikata ose Kualifikimi i Formimit Shpirtëror : 2 ECTS, Kredite
Diploma ose Kualifikimi i Shërbesës së Krishterë: 8 ECTS, Kredite

Lëndët e përzgjedhura

E drejta për të përzgjedhur i jep qendrës mësimore mundësinë për të forcuar disa togje jashtë minimumit të kërkuar ose duke ofruar disa kurse për më shumë ECTS, kredite, ose duke shtuar disa kurse. Në një mënyrë shumë të kufizuar u jep gjithashtu studentëve në mënyrë individuale opsione për të përzgjedhur. Të gjitha zgjedhjet duhet të bien në një nga nëntë togjet e përshkruara më sipër ose të jenë në fushat e anglishtes (Të gjithë numrat e kurseve fillojnë me ENG në anglisht.

Çertifikata ose Kualifikimi i Formimit Shpirtëror : 18 ECTS, Kredite
Diploma ose Kualifikimi i Shërbesës së Krishterë: 20 ECTS, Kredite

D. KEN DHE PROCESI I BOLONJËS

Imazhi i arsimit në Evropë dhe ish- Bashkimin Sovjetik ka ndryshuar në mënyrë drastike që nga viti 1999, kur ministrat e arsimit nga 29 vënde evropiane dhe nga ish - Bashkimi Sovjetik nënshkruan Deklaratën e Bolonjës për të krijuar një zonë evropiane dhe shtetet e ish Bashkim Sovjetik për arsimin e lartë deri në vitin 2010. Ky proces e ka origjinën nga vetëdija që pavarësisht nga diferencat mes shteteve të ndryshme, sistemi i arsimit të lartë në Evropës dhe shtetet e ish Bashkimit Sovjetik është duke u përballur me sfida të përbashkëta, të brendshme dhe të jashtme, në lidhje me rritjen dhe diversifikimin e arsimit të lartë, punësimin e të diplomuarve, mungesa e aftësive në fushat kryesore, dhe shtrirjen e arsimit privat dhe publik përtej kufijve kombëtarë.

.Autoriteti më i lartë i Edukimit European (ALEE) si organizatore te takimitne 1999 u krijau zyrtarisht ne 2010 me takimin ne Budapest dhe Viene. Ne ate kohe edhe Kazakistani u be anetare e ALEE sebashku me 47 anetare dhe 7 prej tyre jane anetare te Baskimit European. Me perjashtim te Kosoves dhe Kirgistanit te gjitha vendet e KEN-it kane qendra mesimore qe jane anetare te Procesit te Bolonjes. Me shume info mund te gjendet mbi ALEE dhe procesin e Bolonjes ne [www. ehea.info](http://www.ehea.info).

-Deklarata fillestare përfshin gjashtë objektiva:

- Të miratojnë një kuadër të përbashkët të diplomave të kuptueshme dhe të krahasueshme me njëra - tjetrën. Një Diplomë Plotësuese, e cila siguron një gjykim të lirë dhe një përshkrim të sistemit kombëtar të arsimit të lartë, duhet të ndërtohet mbi Diplomën e shkolles së mesme dhe /ose të shkollës së lartë që i jepet studentit
- Të miratojnë një sistem të bazuar në dy cikle, nivel universitare dhe pasuniversitare, në të gjitha vendet, e cila më vonë u zgjerua me një cikël të tretë në nivel të doktoratës. (Cikli i parë është ekuivalent me shkallën Bachelor amerikan, dhe ciklin e dytë të nivelit Master.)
- Të krijojnë një sistem Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të Kredive (ECTS) i cili është një sistem i përqëndruar tek studenti dhe i bazuar në ngarkesën mësimore që i kërkohet studentit për të arritur objektivat e programit.
- Për të promovuar një lëvizje më të gjerë të studentëve, mësuesve, dhe studiuesve që bëjnë kërkime, midis vendeve të ndryshme evropiane.
- Për të nxitur bashkëpunimin mes institucioneve arsimore dhe organizatave për të siguruar cilësi të lartë të arsimit.
- Për të nxitur një dimension të veçantë evropian në arsimin e lartë në fusha të tilla si zhvillimin e programit mësimor, bashkëpunimi midis institucioneve, si dhe lëvizshmërinë e studentëve dhe profesoreve në mes institucioneve arsimore.

Karakteristika më e vecantë e Procesit të Bolonjës është Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Kredive (ECTS), pasi ajo ka për qëllim të zhvillojë një sistem arsimor të krahasueshëm nëpërmjet shteteve të ndryshëm.

Çfare është ECTS?

EuNC ndjek sistemin evropian të akreditimit, i quajtur Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Kredive (ECTS). Ky është një sistem i përqëndruar tek studenti dhe i bazuar në ngarkesën mësimore që i kërkohet studentit për të arritur objektivat e programit. Sistemi ECTS kërkon që çdo detyrë e kërkuar duhet të deklarojë numrin e orëve të nevojshme për studentin për të përmbushur kërkesat e programit.

Oret e shpenzuara ne studim

Një ECTS është i barabartë me 25-30 orë studimi për studentin. Cdo orë mësimi që studenti ka kaluar me një aktivitet mësimi për të arritur rezultatet arsimore të synuara është e numëruar si orë studimi. Këto aktivitete mund të jenë orë mësimi në klasë, lexim, detyra me shkrim, prezantime, aktivitete për të kontrolluar detyrat, praktika, mentorimi, apo ndonjë aktivitet tjetër që do të ndihmojë nxënësit të arrijnë rezultatet e synuara.

Ngarkesa Mësimore dhe Kohëzgjatja e Programeve

Kriteri për një vit studimi me kohë të plotë është 60 ECTS (1800 ore studimi). Çdo nivel studimi në KEN, përbëhet, pra, prej 60 ECTS. KEN nuk ofron mundësi për të studiuar me kohë të plotë.

Duke u fokusuar në punën e studentëve, e me pas tek ngarkesa e profesorit të gjitha kurset variojnë në aktivitetin e të mesuarit për të arritur objektivat e kursit që përfshihen në Kohën e të mesuarit, projektet, leximet, reflektimet personale, esete e të tjera. Kur planifikon për kursin, mesuesi duhet të bëjë plane për një mesatare javore 11- 15 ore të punës së tyre, dhe përshin këtu aktivitetet e kursit me matjere të kohës..

Krahasimi me Sistemin e Krediteve të Universiteteve në SHBA

Dallimi më i madh mes ECTS dhe sistemit të krediteve të Kolegjit amerikan është se i pari është i bazuar në ngarkesën e studentëve dhe të dyti në orët e kushtuara mësimi. (Rregull bazë për sistemin e krediteve amerikan është se për çdo orë në klasë, studentët duhet të studiojnë dy orë jashtë klasës.) Ndërsa ECTS është më e orientuar drejt studentëve (koha e nevojshme që i duhet studentit për të përmbushur synimet e programit), sistemi amerikan është më e orientuar drejt profesorit (kohë që një profesor duhet të kalojë për të përgatitur mësimin).

Teknikisht, ECTS nuk ka aktivitete të përbashkta ose aktivitete më shumë, sepse çdo aktivitet i nevojshëm për të përmbushur rezultatet e synuara të programit është vlerësuar me një numër të caktuar ECTS.

Konvertimi i përdorur nga KEN mes krediteve të ECTS dhe krediteve të kolegjit Amerikan është :

0.50 ECTS	=	0.30 US Ore Krediti Kolegji
0.83 ECTS	=	0.50 US Ore Krediti Kolegji
1.00 ECTS	=	0.60 US Ore Krediti Kolegji
1.67 ECTS	=	1.00 US Ore Krediti Kolegji
2.00 ECTS	=	1.20 US Ore Krediti Kolegji
2.50 ECTS	=	1.50 US Ore Krediti Kolegji
3.00 ECTS	=	1.80 US Ore Krediti Kolegji
3.33 ECTS	=	2.00 US Ore Krediti Kolegji
4.00 ECTS	=	2.40 US Ore Krediti Kolegji
5.00 ECTS	=	3.00 US Ore Krediti Kolegji
6.67 ECTS	=	4.00 US Ore Krediti Kolegji
8.33 ECTS	=	5.00 US Ore Krediti Kolegji

E. ZHVILLIMI I STUDENTEVE NE KEN.

1. Qëllimi dhe funksioni.

Filozofia arsimore e EuNCs është e përqendruar në përgatitjen e personave për mision dhe shërbese me anë të përsosmërisë akademike, formimit shpirtëror të vazhdueshëm,

praktik dhe zhvillim të aftësive në shërbesë të cilat janë profesionale dhe që pasqyrojnë një qëndrim të ngjashëm me natyrën dhe sjelljen e Krishtit si shërbëtor. Ne jemi të vetëdijshëm se përgatitja për shërbesë nuk mund të kufizohet nga çfare mund të ndodh brenda në orën e mësimit, as do të jetë kurrë plotësisht i matur nga një dëftese akademike zyrtare. Studentët duhet të jenë të përgatitur në mënyre të gjithanshme, sepse në mënyre të gjithanshme do t'ju kërkohet për të shërbyer. Funkzioni i zhvillimit të studentëve në KEN egziston që të mbështesë, të ndihmojë rritjen, dhe të krijojë një mjedis akademik për të mësuar, në mënyrë që çdo student mund të përfitojë sa më shumë të jetë e mundur nga marrdhënia e tyre me KEN.

KEN ka adoptuar një liste Rezultatesh Arsimore. Këto rezultate janë : përmbajtja, kompetenca, konteksti, dhe karakteri, të cilat janë rezultatet e synuara për përgatitjen e klerise, siç parashikohet nga Kisha e Nazaretasit.

Aktivitetet dhe përpjekjet e zhvillimit të studentëve mbështesin në mënyre të drejtpërdrejtë Rezultatet Arsimore të synuara, por që të jetë me të vërtetë i dobishëm, këto përpjekje duhet të angazhojnë nxënësit në kontekstin e marrëdhënieve dhe dialogut. Vetëm brenda këtij konteksti është e mundur që përpjekjet e Zhvillimit të Studentëve të adresojnë çështjet kyçe për zhvillim në pikat kryesore ku nevojat e studentëve dhe rezultatet e dëshiruara arsimore takohen në një pikë të përbashkët.

Zhvillimi i Studentëve në KEN aktualisht përfshin këto sfera, por nuk është rreptësisht i kufizuar nga ato:

1. Orientimi dhe ngjarjet e mikpritjes.
2. ACP1000 Orientimi ne KEN.
3. Komunitetet e studimit te Student
4. Mentorimi
5. Praktika
6. Praktika e studentit
7. Integrimi ne sherbese.

2. Përmbledhje

1. Orientimi dhe ngjarjet e mikpritjes.

Qellimi: Te mireprese anetaret e rinj te komunitetit – studentet, fakultetin, dhe stafin – ne qendren mesimore locale te komunitetit dhe tu jape anetareve nje mundesi per tu rikthyer, te rikujtuar, rifokusuar, ne komunitetin e tyre me lidhje dhe qellime e tyre per tub ere pjesees edukimit te KEN.

Përshkrimi: TE përfshihet efektivisht, ne nejt komunitet me anetare te rinj, duke dhene informacione per ambientin e ri, dhe at ate përfshihen ne miqesine e komunitetit. Ne disa vendndodhje kjo mund te merret ne kontekstin si nejt ririt. Disa nga informacionet e hyrjes mundte ndahen online ose permes emailieve para se te takohen balle per balle. Cfaredo te ndodhe, cilido te jete formati, jo gejt invest ne zhvillimin e komunitetit qe ia vlen te investohet ne bashkepunimin akademik se bashku.

2. ACP1000 Orientimi ne KEN.

Qellimi : Të orientoje studentet ne ambientetet akademike dhe tek pritshmerite e EuNC dhe te siguroje qe ata te prezantojne celesat e informacioneve akademike dhe nevojen e suksesit te per qelimet e studenttit.

Përshkrimi: Ky eshte nje kurs online qe duhet te merret si kursi I pare. Kjo gje provon informacionin e rendesishem akademik si jpesa e KTN. Nuk ka kosto per kete klase por as kredite.

3. Komunitetet e studimeve te studentit.

Qellimi. Krijon nje ambient ku studentet mund te zhvillohen ne menyre gjithepërshirese dhe dhe atje ku studimet akademike te tyre mud te suportohen si pjesa e zhvillimit.

Përshkrimi: Nderton marredhenie me studentet e tjere, jeton me një vetëdije dhe shqetësim për të tjerët, dhe gezo miqesine e komunitetit qe jane si mundesi per zhvillimin e tyre. Ne I inkurajoje studentet kudo qe ata ndodhen t ejeen te qellimshme duke marre avantazhet e ketyre mudesive.

4. Mentorimi

Qellimi. Te siguroje eksperience formale qe qe do te investoje ne formimine e karakterit te tyre, ne zhvillimin e jetes, dhe ne formimin shpirteror te studenteve. Duke suportuar studentet ne menyre gjithepërshirese, mentori personal dhe aktivitetet mentorale,, gjithashtu suportojne zhvillimin akademik te studenteve.

Përshkrimi: Mentorimi formon nga nejt vend ne nje tjeter ne menyra te ndryshme, por qellimi I tij nuk ndryshon: te investoje ne zhvillimin gjithepërshires te studentetve. Oret e mentorimit mund te përfshijne nje nga nje mentoriet experencen ne grupe te vogla pushimet ose aktivitetet shpirterore, ose fokusin ne seminare ose aktivite qe zhvillojne stresin holistik dhe/ose zhvillimin e e afesive te jetes. Studentet marrin kredite akademike per mentorimin. Studentet e rekomandohen te vazhdojne marreheniet me mentoret, pasi marrin minimumin e krediteve te kerkuara. (1 ECTS per ÇF dhe 2 ECTS per DK).

5. Praktika:

Qellimi: Ky është program praktik në shebesen e Krishtere në të cilën studentët shfaqin praktiken në sherbese. Në mbikqyrjen e një sherbyesi apo të një stafi të zhvillimit të studentët zhvillojnë aftësitë bazë të sherbese dhe drejtohen në të kuptuarit e tij/saj në sherbese personale.

Pershkrimi: E paktë një praktike e kërkuar për të kompletuar Sherbesen e Diplomes së Krishtere, në programin e KTN dhe duhet të perfundojë studimet akademike. Është përgjegjësi e studenteve të gjejë një vend për të bërë praktiken dhe zhvillimin e qëllimit të eksperiencës të të mesuarit.

Studentët marrin kredite akademike për këto detyra.

6. Praktikumi

Qellimi: Të ndihmojë studentët të marrin aftësi praktike dhe eksperiencë në mënyrë të ndryshme në fusha të ndryshme të lidhjes me shebesen duke përfshirë administrimin, adhurimin dhe/ose aktivitetet e formimit shpirtëror, punën e ekipit dhe dinamikën e grupit, menaxhimin e kohës, financat dhe buxhetimin, vendimmarrjen dhe shkathhtësitë e tjera praktike të liderit).

Pershkrimi : përgjatë kalendarit të kurseve akademike, studentët duhet të përfshihen në praktikë, sherbesat lokale. Eksperiencën e praktikumit duhet të përfshijë studentët në një varietet të nevojave bazë të aftësive të sherbese. Me ashpër krijon një të mesuar të qëllimshëm në orët e praktikës studentët do të takohen me pritjet e skuadërve ose me rolin e sherbyesit.

Studentët marrin kredite akademike për këto detyra.

7. Sherbese e Integruar

Qellimi: Të ndihmojë studentët të integrohen në kurset e integritit të sherbese si një model për sherbesen në kishën lokale, dhe të zhvillojë aftësitë e sherbeseve të studentit.

Pershkrimi Ky është një kurs i rëndësishëm që studentët marrin në përfundim të kualifikimit në Programin e Sherbeseve të Krishtere. Studentët marrin kredite akademike për këto klase.

VI. PROGRAMET E EU NC/KEN-IT.

EuNC ofron kater programe të ndryshme, nga te cilat dy jane te akredituar nga Shoqata Evropiane Ungjillore Akredituese (EEAA). Akreditimi i garanton Kolegjit nivelin e edukimit dhe mundesine e sigurte per te vazhduar studimin ne institucione te tjera edukative.

Programet e akredituara dhe te paakredituara kane te njejten kurse dhe te njejten ore mesimore per studentet. Ndryshimi gjendet ne nivelin akademik dhe ne sistemin e vleresimit.

Ne faqet pasardhese pershkruhen te dhenat e pergjithshme dhe minimumi i kerkesave per keto programe. Zbatimi per kerkesat e pergjithshme varet nga vendndodhja se ku keto programe po afrohen. Per detaje te ketyre kerkesave per cdo vendndodhje kryesisht per programin e Diplomes se Krishtere, shiko dokuentin e Kerkesave te Shuqurimit per pershkrimin e kurseve specifike referohu faqeve 60 ne kete katalog.

A. CERTIFIKATA E FORMIMIT SHPIRTEROR (CFSH) DHE KUALIFIKIMI NE FORMIMIN SHPIRTEROR (KFSH)

PËRSHKRIMI

Ky program përbëhet nga 60 ECTS, kredite. Ai do të thellojë njohuritë e studentëve për Biblën dhe besimin e krishterë dhe është përcaktuar për të ndihmuar ata në rritjen shpirtërore dhe të inkurajoje përfshirje më të madhe në kishën lokale.

Certifikata e këtij programi është akredituar nga EEAA dhe është i barazvlefshëm me vitin e parë të kualifikimit profesional në Bachelor.

Programi i kualifikimit nuk është i akredituar. Diferencimi më i madh mes akreditimit dhe jo akreditimit të programit janë të lidhura ngushtesisht me kualifikimin e profesorit (kerkesat e Diplomes ku mesuesi duhet të ketë të paktën një master në fushën ku ai meson) dhe aftësinë e burimeve të gjuhës së studentit, duke qenë se shpesh prej tyre nuk mund të lexojnë në gjuhën angleze. Te dy programet kanë të njëjtin kurrikul dhe perdoren të njëjtet rruge. Te y kane si kerkesa ngarkese mesimore per cdo student.

Rezultatet e Programit

Studentët që diplomohen me Çertifikatën ose Kualifikimin e Formimit Shpirtërorë do të kenë

- një njohuri bazë në Shkrimin (CN1)* dhe të besimit të krishterë, veçanërisht nga prespektiva Uesliane (CN2).
- një të kuptuar të qartë të vizionit për Misionin e Kishës (CN3) dhe Përgjegjësia e Kishës për Botën dhe Njerëzit e tij (CT3).
- të fillojnë të zbatojnë njohuritë që kanë marrë në jetën e tyre personale (CH1).
- të rritur në ndjekjen e jetës së shenjtë në të gjitha dimensionet e jetës së përditshme. (CT4) dhe si individ (CH2) nëpërmjet njohjes me disiplina të ndryshme shpirtërore (CH4).
- një rritje e të qenit të informuar se cilët janë ata si individ (CH5) dhe si shërbyes të përfshirë në misionin e Perëndisë në botë (CH3).

Vini Re: Plani mësimor është përcaktuar duke kuptuar që asnjë program edukimi nuk është i kompletuar, por ka nevojë të shikohet si shtresë bazë për mësimin gjatë gjithë jetës.

* Shkurtimi i referohet rezultateve edukuese të menduara, siç janë përshkruar në faqen 37 ë këtij katalogu.

KERKESAT MINIMALE AkademiKE PER DIPLOMIM

- Do të numërohen vetëm kurset me notë kaluese.
- Studentët duhet të plotësojnë 60 ECTS, kredite të shpërndara si më poshtë :

TOGU	Kurse	
	Kreditet	
A. Bibla	Hyrje në Dhjatën e Vjetër	5
	Hyrje në Dhjatën e Re	5
	Themeli per Studimet e Bibles	5
B. Teologji, Tradite, dhe Identit	Hyrje në Teologji	3
	Shenjtëri dhe Identitet	3
C. Misioni i Perëndisë, Kisha dhe Thirrja	Misioni i Perëndisë, Kisha e Thirrja	3
	Thirrja dhe Shërbesa Personale	2
	Formimi Shpirtëror	3
	Mentorimi	1
	Ubgjillizimi, Kisha ose	
	Adhurimi I Krishtere	3
	Zhvillimi I Krishtere Faith ne kishen ne Lokale	3

D. Specialitetet e Shërbesës	Kurse me zgjedhje: Predikimi, Themeli I shërbesës tek te rinjte dhe te familjet; Kujdesi pastoral dhe Keshillimi, Drejtimi I Kishes. Praktikumi,	3 1
E. Aftesite akademike dhe studimet e orientimit	Hyrje ne KTN Hyrje ne to Aftesite akademike	0 2
Kurse me zgjedhje:		18
Totali		60

B. DIPLOMA E SHËRBESËS SË KRISHTERË DHE KUALIFIKIMI NE SHERBESEN E KRISHTERE.

Përshkrimi

Ky program përbëhet nga 120 ECTS kredite dhe ka si qëllim të përgatisë studentet për shërbesë në kishat lokale. I varur nga kriteret e vecanta të caktuara nga cdo distrikt, ky program përmbush minimumin e kërkesave për shërbesën e shuguruar në kishën e Nazaretit. Në disa raste, distrikti do të kërkojë kredite shtesë përveç 120 Krediteve të programit.

Ky program i akredituar nga Shoqata Evropiane Ungjillore Akredituese (EEAA) korrespondon me kualifikim minimal në nivelin 5B në kuadrin ISCED (Klasifikimi Ndërkombëtar i Standardave të Arsimit) ose 554 të UNESCO-s. Niveli i këtij programi është ekuivalent me dy vitet e para të kualifikimit të Bachelorit në Profesion (Vocational Bachelor).

Programi i kualifikimit nuk është i akredituar. Diferencimi me i madh mes akreditimit dhe jo akreditimit të programit janë të lidhura ngushtesisht me kualifikimin e profesorit (kerkesat e Diplomes ku mesuesi duhet të ketë të paktën një master në fushën ku ai meson) dhe aftesinë e burimeve të gjuhës së studentit, duke qenë se shue prej tyre nuk mund të lexojnë në gjuhën angleze. Te dy programet kanë të njëjtin kurrikul dhe perdoren të njëjtet rruge. Te y kanë si kerkese ngarkese mesimore per cdo student.

Rezultatet e programit.

Studentët të cilët diplomohen me Diplomën e Shërbesës së Krishterë do të kenë:

- njohuri bazë të Biblës (CN1)* dhe Besimit të Krishterë, veçanërisht një prespektivë Uesliane (CN2) dhe të Historisë së Kishës (CN3).
- një të kuptuar të qartë të vizionit për Misionin e Kishës (CN3) dhe përgjegjësitë e kishës ndaj botës dhe njerëzve të saj (CT3).
- njohuri bazë të nevojshme për një shërbesë efektive (CN4) dhe për të

- punuar me njerëzit (CN5).
- aftësi bazë për të interpretuar Biblën (CP1) dhe për të komunikuar me efektivitet (CT1) brënda konteksteve të kulturave të ndryshme (CT2).
- aftësi bazë për të komunikuar qartësisht me njerëzit (CP2), për të siguruar udhëheqje (CP3) dhe kujdes pastoral ndaj njerëzve (CP4)
- aftësi për të zbatuar të kuptuarit e krishterë në jetët e tyre personale (CH1).
- rritje në kërkimin e një jete të shenjtë, në të gjitha dimensionet e ndryshme të jetës së përditshme (CT4) dhe njeriu (CH2) me anë të njohjes së disiplinave të ndryshme shpirtërore (CH4).
- një rritje ndërgjegjësimi se kush janë ata si individ (CH5) dhe si shërbyes të përfshirë në misionin e Perëndisë në botë (CH3).

Vini Re: Plani mësimor është përcaktuar duke kuptuar që asnjë program edukimi nuk është i kompletuar, por duhet të shikohet si themel për procesin e të mësuarit për gjatë gjithë jetës.

* Shkurtimi i referohet rezultateve edukuese të menduara, siç janë përshkruar në faqen 37 të këtij katalogu.

Kërkesat Minimale për Diplomim.

- Do të numërohen vetëm kurset me notë kaluese.
- Studentët duhet të plotësojnë 120 ECTS, kredite të shpërndara si më poshte

<i>Togu</i>	<i>Kurse</i>	<i>ECTS</i>
A. Bible 25 ECTS	Hyrje në Dhjatën e Vjetër	5
	Hyrje në Dhjatën e Re	5
	Hermenautika	5
	Pentat or Profetët e DH Vj	5
	Ungjijtë Sinoptikë ose Literatura Palit	5
B. Teologji, Traditë, Identitet 23 ECTS	Hyrje në Teologji	3
	Shenjtëri dhe Identitet	3
	Doktrina e Krishterë	6
	Historia dhe Qeveria Nazaretase	3
	Historia e Kishës	5
	Etikae Krishtere	3
C. Misioni i Perëndisë; Kisha dhe Thirrja 23 ECTS	Misioni i Perëndisë; Kisha	3
	Thirrja dhe Shërbesa Personale	2
	Formimi Shpirtëror	3
	Mentorimi	2
	Rinovimi i Ungjillizimit & Kishës	3

	Misioni Ndërkulturor	4
	Zhvi i Besim në Kongacio Lokal	3
	Adhurim i Kishës	3
D. Specialitetet e Shërbesës 21 ECTS	Kurse me zgjedhje:	10
	Predikimi: Kujdesi dhe Këshillimi Pastoral	
	Themelet për Shërbesën ndaj të Rinjëve dhe Familjes; Udhëheqja në Kishë	
	Praktikumi	1
	Praktika, dhe Stazhi 1	3
	Integrimi në Shërbesë	3
	Komunikimi Ndërpersonal	2
	Me zgjedhje: Practicum(et)/Stazhi(et)	2
E. Aftësitë Akadematike Dhe Studime te Pergjithshme 8 ECTS	Orientimi i KEN	0
	Hyrje ne aftesite Akadematike	2
	Shprehje Gjuhësore dhe Shkrimore	3
	Rritja dhe Zhvillimi njerezor	3
	Kurse me zgjedhje:	20
Total		120

VII. KËRKESAT ARSIMORE për SHUGURIM

Diploma e Shërbesës së Krishterë dhe Kualifikimi i Shërbesës së Krishterë në KEN plotësojnë kërkesat minimale për shungurim brenda Kishës së Nazaretasit. Të katër rezultatet: Përbajtja, Kompetenca, Karakteri, dhe Konteksti që KEN përdor në programin e tij mësimor janë identike me rezultatet që Kisha e Nazaretasit përdor për të përshkruar një kurs të vlefshëm studimi për shungurim (Manuali i Kishës së Nazaretasit. Të 120 ECTS e Diplomës së Shërbesës së Krishterë dhe Kualifikimit të Shërbesës së Krishterë përbajnë një total prej 3600 orë studimi, e cila kalon standartin e orëve të studimit të përcaktuara nga Komiteti Këshillues i Kurseve të Studimit në Rajonin e Eurazias.

Në zhvillimin e programit të Diplomës dhe Kualifikimit në Shërbesën e Krishterë, çdo qendër mësimore ka ndjekur kërkesat minimale të përcaktuara në faqen 52 të këtij katalogu, dhe çdo qendër mësimore ka përdorur 20 kredite të zgjedhura në mënyrë që t'i përdore për të përforcuar disa kurse të caktuara, duke u ofruar atyre më tepër ECTS, ose duke shtuar kurse në programin mësimor. Ky opsion për zgjerim lejon që çdo qendër mësimore të jetë e ndjeshme në disa nga sfidat dhe shqetësimet të kontekstit përkatës. Për një përshkrim më të detajuar të programeve të ndryshme të Diplomës dhe Kualifikimit në Shërbesën e Krishterë që ofrohet në secilën nga qëndrat e studimit, shiko në faqen

Një distrikt i Kishës së Nazaretasit mund të vendose të shkojë përtej kërkesave minimale për shungurim të 120 ECTS. Kurse plus, përveç atyre të përfshirë në Diplomën dhe Kualifikimin e Shërbesës së Krishterë, që janë të nevojshme për shungurim në çdo distrikt, janë të listuara në një listë të ndarë, menjëherë pas programit mësimor të Shërbesës së Krishterë të çdo qendre mësimore. Për shkak të kërkesave të ndryshme të distrikteve Evropiane dhe të shteteve të ish Bashkimit Sovjetik, është e rëndësishme të kuptohet se një kandidat për shungurim ka gjithmonë nevojë të përmbush kërkesat e vendosura nga distrikti ku ai ose ajo do të marrë shungurimin.

VIII. NUMRAT E KURSEVE

Kodet e Kurseve përbajnë shkronja dhe shifra. Shkronjat identifikojnë togun ku ofrohen kurset. Për shembull, BIB = Togu A Bibël. Dy numrat me shifra tregojnë vëndin e kurseve në tog. Shembull: BIB11 = Hyrje në Dhjatën e Vjetër. Shifra e parë tregon nivelin e studimeve në të cilin merret kursi normalisht. BIB11 është kursi i nivelit të parë, *Numrat e kurseve të mëposhtëm nuk janë kodet e plota të kurseve. Kodet e plota të kurseve kanë katër shifra.* Shifra e tretë tregon nëse kursi është i ndarë në pjesë të caktuara. THE231x është pjesa e parë dhe THE232x pjesa e dytë e Historisë së Kishës..

Shifra e katërt tregon numrin e ECTS, krediteve që marrin studentët pas plotësimit të suksesshëm të kursit. Kjo zakonisht varion nga 0 dhe 6 kredite. THE2323 tregon që pjesa e dytë e Historisë së Kishës ofrohet për 3 ECTS, kredite. Në disa raste prapashtesa plotëson numrin e kurseve, duke treguar se me anë të cilit sistem shpërndarës është ofruar kursi, të tjerë përveç kursit normal. Prapashtesat e mëposhtme përdoren në EuNC:

D = Studime të Drejtëpërdrejta

C = Kurs i ofruar në program të paakredituar.

Lista e kurseve prezanton të gjitha kurset e ofruara nga EuNC-ja. Disa mund të ofrohen vetëm në disa qendra mësimore, Disa kurse mund të mos kërkohen për asnjë program, por mund të ofrohen si fakultative ose studime të drejtëpërdrejta kur është e nevojshme dhe nëse fakulteti është i gatshëm.

Togu A: Bibla

BIB11	Hyrje në Dhjatën e Vjetër
BIB12	Hyrje në Dhjatën e Re
BIB14	Hermenautika
BIB21	Pentatuku
BIB22	Ungjijtë Sinoptikë
BIB23	Literatura e Palit
BIB24	Profetët e Dhiatës së Vjetër
BIB25	Literatura e Gjonit

Togu B: Teologji, Traditë dhe Identitet

THE10	Konferencat Teologjike
THE11	Hyrje në Teologji
THE13	Shenjtëri dhe Identitet
THE21	Doktrina e Krishterë
THE22	Historia dhe Qeveria Nazaretase
THE23	Historia e Kishës
THE24	Studime të Vecanta në Teologji dhe Historia e Kishës
THE25	Etika e Krishterë (para kursit GEN21)
THE31	Teologjia e Xhon Uesl-it (John Wesley)
THE32	Apologjika e Krishterë
THE42	Teologjia e Shenjtërimit Bashkëkohor

Togu C: Misioni i Perëndisë; Kisha dhe Thirrja

MIS10	Mentorimi
MIS11	Misioni i Perëndisë dhe Kisha
MIS12	Thirrja dhe Shërbesa Personale
MIS13	Formimi Shpirtëror
MIS14	Hyrje në Mentorim
MIS41	Karakteret e Shërbyesit

PAS11	Zhvillimi ibesimit ne Kishen locale.
PAS21	Adhurimi i Krishterë
PAS22	Zhvillimi i Kishës
PRC21	Ungjillizimi dhe kisha
PRC22	Intercultural Missions (replaced by new course PRC24)
PRC23	Sherbesat Urbane
PRC24	Misioni Ndërkulturor (i ri)

Togu D: Specialitetet e Shërbesës

MIN10	Koferenca e Udhëheqësisë
MIN11	Practicumi
MIN20	Hyrja ne muziken e kishes
MIN22	Predikimi
MIN23	Themelet për Shërbesën e të Rinjve dhe Familjes
MIN24	Kujdesi dhe Këshillimi Pastoral:
MIN25	Udhëheqësia e Kishës:
MIN26	Program Stazhor
MIN27	Sherbesa e intergruar
MIN28	Studime të veçanta në Shërbesën e Krishterë
SOC21	Komunikimi Ndërpersonal dhe Ndërkulturore (Perseritje nga kursi SOC24)
SOC23	Martesa dhe Familja
SOC24	Komunikimi Interpersonal (I ri)
SOC32	Hyrje ne Problemet Sociale.

Togu E: Aftësi Akademike

ACP10	Hyrje në Studimet e Kolegjit
ACP11	Hyrje ne aftesite Akademike.
ACP20	Shprehje Gjuhësore dhe Shkrimore
GEN20	Hyrje ne Filozofi
GEN22	Besimet boterore
SOC22	Rritja dhe zhvillii njerezor
SOC31	Sociologji e pergjithshme.

IX. PËRSHKRIMI I KURSEVE

Togu A: Bibla

BIB11 Hyrje në Dhjatën e Vjetër

Kjo lëndë është një lëndë hyrëse në letërsinë e Dhjatës së Vjetër. Ajo analizon temat, historinë, dhe karakterin letrar të librave të Dhjatës së Vjetër, gjithashtu reflekton mbi rëndësinë e mesazhit të tyre në shoqëri bashkëkohore.

Kjo lëndë e nivelit të parë është e domosdoshme për të gjitha programet e KEN-it.

BIB12 Hyrje në Dhjatën e Re

Kjo lëndë është një lëndë hyrëse në letërsinë e Dhjatës së Re. Ajo analizon mjedisin tematik, historik, social dhe kulturor, si dhe tipologjinë e literaturës së librave të Dhjatës së Re. Kjo lëndë reflekton gjithashtu mbi rëndësinë dhe dëshminë e Jezus Krishtit në shoqëri bashkëkohore.

Kjo lëndë e nivelit të parë është e domosdoshme për të gjitha programet e KEN-it

BIB14 Hermenautika

Kjo lëndë është një lëndë hyrëse mbi principet dhe praktikën e interpretimit biblik dhe është ndërtuar në mënyrë që të zhvillojë aftësitë e studentit për të komunikuar Fjalën e Perëndisë. Ajo do të përqëndrohet mbi: mësimin e mjeteve dhe proceseve të përshtatshme për interpretimin dhe vënien në praktikë të Fjalës; kuptimin e principeve të interpretimit që janë specifike për format e ndryshme letrale; angazhimin me tema të ndryshme dhe problematikat që ndikojnë mbi mënyrën e të interpretuarit të Biblës në kishë.

Kjo lëndë është lëndë e nivelit të parë dhe ka si kusht paraprak mbarimin e lëndëve Hyrje në Dhjatën e Vjetër dhe Dhjatën e Re. Përfundohet që të dy kurset biblike të jene përfunduar para këtij kursi.

BIB21 Pentateuku.

Kjo lëndë është një studim mbi pesë librat e parë të Dhjatës së Vjetër, duke i dhënë më shumë rëndësi historisë treguese që përshkruan librat nga Zanafilla tek Ligji i Përtërirë, temat teologjike që dalin nga ky material, dhe mënyrën se si Torah formon identitetin e Hebrenjve. Lënda përfshin gjithashtu një hyrje të shkurtër mbi metodat e studimit të këtyre pesë librave.

Kjo ka të parakërkuar Hyrje në Dhjatën e Vjetër dhe Hermenautiken .

BIB22 Ungjijtë Sinoptikë

Kjo lëndë është e bazuar mbi studimin e tre Ungjijve, më një vëmendje të vecantë mbi kontekstin, strukturën letrare, mesazhin teologjik, si dhe ngjashmëritë dhe diferencat mes tyre. Kursi do të përmbajë studime esegjetike të këtyre Ungjijve duke u bazuar mbi përkthimet moderne. Kjo lëndë shtrin themelet mësimore për subjektet hyrëse të Biblës dhe siguron mundësinë për të zhvilluar aftësitë eksegjetike dhe ekspozuese të cilat janë të rëndësishme për studime Bible efektive, predikime, dhe shërbesë. Këto libra janë studiuar brenda një kuadri i cili është i rëndësishëm për komunitetin e besimtarëve.

Kjo është një lëndë e nivelit të dytë dhe ka si kusht paraprak mbarimin e lëndës Hyrje në Dhjatën e Re dhe Hermenautiken.

BIB23 Literatura e Palit.

Kjo lëndë është një studim induktiv të mendimit dhe jetes së Palit, kusi fokusohet tek studii dhe begraundi mbi një studim eksegjetik të këtyre tre letrave duke u bazuar mbi përkthimin e tyre në gjuhën moderne. Kjo lëndë shtrin themelet mësimore për studentët për subjektet hyrëse të Biblës dhe siguron mundësinë për të zhvilluar aftësitë eksegjetike dhe ekspozuese të cilat janë të rëndësishme për studime Bible efektive, predikime dhe shërbesë. Këto libra janë studiuar brenda një kuadri i cili është i rëndësishëm për komunitetin e besimtarëve.

Kjo lende ka të parakerkuar Hyrje në Dhjatën e Re dhe Hermenautiken.

BIB24 Profetët e Dhjatës së Vjetër

Kjo lëndë është një studim i mesazhit dhe mjedisit të profetëve të DhV. Qëllimi kryesor është të ekspozojë studentin ndaj principeve më të rëndësishme për interpretimin e profetëve të DhV, kontekstit të profetëve dhe domethënien e mesazhit të tyre për shoqërinë bashkëkohore. Një rëndësi e vecantë do të jepet disa nga profetëve të shekullit të 8-të dhe 7-të.

Kjo lende ka të parakerkuar Hyrje në Dhjatën e Vjetër dhe Hermeneutiken.

BIB25 Literatura e Gjonit

Kjo lëndë është një studim induktiv i Ungjillit dhe letrave të Gjonit, dhe Apokalipsit. Ajo përfshin ambjentin historik/kulturor, strukturën letrare, dhe mesazhin teologjik të përfshirë në këto shkrime, duke i dhënë rëndësi të vecantë studimit induktiv të tekstit bazuar në përkthimin modern. Këto libra do të studiojnë besimin e tyre në komunitetin krishterë.

Kjo lende ka si kusht paraprak mbarimin e të gjitha lëndëve Biblike të niveleve më të ulta (Hyrje në Dhjatën e Vjetër dhe Dhjatën e Re, Hermenautikën, dhe lëndët e tjera si pjesë e studimit të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re)

Toqu B: Teologji, Traditë dhe Identitet

THE10 Konference teologjike.

Kjo klase perfshin pjesemarijen ne konferenca te personave per njerezit ne sherbese ose qe pergatiten per sherbese dhe bejne reflektimin e tyre.

Kjo klase eshte e hapur per te gjithe studentet, dhe varet nga lloji I konferences qe ata marrin pjese.

THE11 Hyrje në Teologji

Kjo lëndë eksploron nevojën për reflektim teologjik në komunitetin e Krishterë dhe në jetën personale dhe u prezanton studentëve disiplinën e reflektimit teologjik, terminologjinë bazë, dhe organizimin e teologjisë si disiplinë akademike.

Kjo lëndë është e nivelit të. Idealisht, është një nga kurset e para që studentët duhet të marrin.

THE13 Shenjtëri dhe Identitet

Kjo lëndë eksploron konceptin biblik të shenjtërisë, doktrinën e perfeksionit të Krishterë sipas artikulimit të bërë nga Xhon Uesli në shekullin e 18-të dhe doktrinën e shenjtërisë të plotë sipas artikulimit të bërë nga Artikujt e Besimit në Kishën e Nazaretasit. Nëpërmjet këtyre pyetjeve biblike, teologjike dhe historike, përgjigjet do të analizohen në bazë të mënyrës se si Kisha e Nazaretasit duhet të artikulojë identitetin e saj si një kishë e shenjtërisë në një shoqëri bashkëohore.

Kjo është një lëndë e nivelit të parë dhe nuk ka kushte paraprake.

THE21 Doktrina e Krishterë

Kjo lëndë eksploron doktrinën kryesore të kishës së Krishterë, nga pikpamja e traditës së Shentërisë Uesliane, duke u përqëndruar tek koncepti i zbulesës, doktrina e Perendisë, Trinitetit, doktrina e njerëzimit, Perëndia shpëtimtar, Perëndia Frymë, Kisha dhe gjërat e të ardhmes.

Kjo lende kate parakerkuar Hyrje në Teologji. Trajtimi i Teologjise kristiane eshte ndare ne dy pjesë: Doktrina e Krishterë 1 dhe Doktrina e Krishterë 2

THE22 Historia dhe Qeveria Nazaretase

Kjo lëndë e ekspozon studentin me pasurinë historike dhe strukturën organizative të Kishës së Nazaretasit. Vëmendje e vecantë i jepet faktorëve historik, teologjik dhe personal, të cilët qenë të rëndësishme për lindjen e denominacionit dhe funksioneve të kishës në nivelin lokal dhe distriktual.

Kjo është një lëndë e nivelit të dytë prandaj ka si kusht paraprak mbarimin me sukses të

Shenjtëri dhe Identitet dhe Historia e e Kishes. .

THE23 Historia e Kishës

Kjo lëndë është një hyrje në historinë e Kishës dhe teologjisë së saj nga periudha e hershme deri në ditën e sotme e paraqitur nga Kisha Lindore dhe Perëndimore.

Historia e kishes shërbesn për të treguar historinë e kishës dhe të theksohet më shumë se periudha të tjera, dhe lënda mund të ofrohet në dy pjesë të ndara

THE24 Studime të Vecanta në Teologji dhe Historia e Kishës

Jo lende nuk ka kurs të parakëruar, përshkrim apo të varet nga specifika të ofrimit.

THE25 Etika e Krishtere. (para GEN21)

Ky kurs synon të ndihmojë studentët të formojnë një qasje personale ndaj etikës dhe çështjeve etike që janë besnike ndaj dëshmisë së Shkrimeve dhe doktrinave të Kishës siç shprehet në traditën Wesleyan. Kështu, kursi do të pasqyrojë mësimet etike të Shkrimeve, do të analizojë marrëdhënien midis teologjisë dhe etikës, dhe do të shqyrtojë mësimet e sistemeve kryesore etike. Nëse është e përshtatshme për kontekstin, çështjet relevante etike do të shqyrtohen në detaje.

Ky kurs kërkon të parakëruar kursin Doktrina a e KRisjtere2, Hermenautiken dhe Hyrje ne Filozofi.

THE31 Teologjia e Xhon Ueslit (John Wesley)

Kjo lëndë përfshin studimin historik të figurës së Xhon Ueslit; udhëtimin e tij shpirtëror dhe zhvillimin e mendimit të tij teologjik. Temat më të rëndësishme të teologjisë së tij do të studiohen më një përqëndrim të vecantë në shpalljen e Perfeksionit të Krishterë.

Kjo lende ka si kusht paraprak Hyrje ne Filozofi dhe Doktrinën e Krishterë

THE32 Apologjëtika e Krishterë

Kjo lëndë eksploron disiplinën teologjike të Apologjetikës, tema të ndryshme të apologjetikës që sfidojnë Krishtërimin bashkëkohor si dhe përgjigjet e Krishtera për të mbështetur detyrën misionare të kishës.

Kjo lende ka si kusht paraprak mbarimin e lëndës së Filozofisë, dhe Doktrinës së Krishterë.

THE42 Teologjia e Shenjtërimit Bashkëkohor

Kjo lëndë studion zhvillimet bashkëkohore të diskutimeve teologjike të Shenjtërisë-Uesliane me një vëmendje mbi doktrinën e shenjtërisë.

Kjo lende ka si kusht paraprak, Shenjtëri dhe Identitet, Doktrinës së Krishterë dhe

Teologjisë Uesliane.

Togu C: Misioni i Perëndisë; Kisha dhe Thirrja

MIS10 Mentorimi

Ky aktivitet i programit mësimor është ndërtuar për të ndihmuar studentët në studimet e tyre dhe në zhvillimin e tyre personal. Mentorimi mund të përfshijë një fushë të gjerë aktivitetesh, por që të gjitha kanë për qëllim të ndihmojnë zhvillimin e studentit, me anë të këshillimit akademik, adhurimit të trupit të Krishtit, drejtimit shpirtëror, diskutimeve të gjërave të rëndësishme mbi shkollën në grupet e vogla.

Mentorimi kerkohet per te gjithë studentet si ne nivelin e Programeve ne Formimin Shpirtëror dhe per Diplomen ne Sherbesen e Krishtere. Nje minimum prej 0.5 ECTS duhet te fitohet per cdo 30 ECTS. Kursi I pare I mentorimit duhet te erret ne fillim te studimeve te KTN-se.

MIS11 Misioni i Perëndisë dhe Kisha

Kjo lëndë është një lëndë hyrëse e cila ekspozon studentët mbi një pikepamje misionare në shërbesë. Me anë të një eksplorimi biblik-teologjik të misionit të Perëndisë, studentët do zbulojnë natyrën esenciale të kishës si trupi i Krishtit në botë i krijuar për të bashkëpunuar me Perëndinë për të përmbushur misionin e Tij në botë.

Kjo është një lëndë e nivelit të parë e përfshirë në të gjitha programet e KEN, sepse prezanton me zemren e misionit te programit te EuNC-se.

MIS12 Thirrja dhe Shërbesa Personale

Thirrja dhe Shërbesa Personale është një lëndë e nivelit hyrës dhe ekspozon studentët ndaj koncepteve të thirrjes personale, dhe i lidh ata me kontekstin e materialeve të prezantuara në lëndët e mëparshme, Misioni i Perëndisë dhe Kisha. Kjo lëndë eksploron çfarë do të thotë të gjesh një vend në shërbesë dhe domethënien personale në planin e Perëndisë dhe Mbretërisë së Tij në bazë të dhuntive të dhëna, aftësive dhe trashëgimisë. Do të zbulohen konceptet historike dhe teologjike të thirrjes, gjithashtu, kjo lëndë është një reflektim i gjerë mbi vetveten dhe një përpjekje për të fituar më shumë siguri personale me potencialin e vecantë që kontribuon mbi misionin e Perëndisë dhe Kishës.

Kjolende ka si kusht paraprak mbarimin e lëndës së Misionit të Perëndisë dhe Kishës.

MIS13 Formimi Shpirtëror

Kjo lëndë ka për qëllim të komunikojë kuptimin e punëve të hirit dhe të përcaktojë disiplinat shpirtërore në jetët e studentëve që po përgatiten për shërbesë në një botë të thye dhe në nevojë për një transformim të shenjtë. Përkushtim i jepet disiplinave shpirtërore klasike, por do të krijohen dhe mundësi për të aplikuar gjërat e mësuara në këtë lëndë, në nivelin personal dhe formimin shpirtëror si trup.

Kjo lëndë është një lëndë e niveli të parë dhe ka si kurs të parakerkuar Misioni i Perendise dhe Kisha.

MIS14 Hyrje ne Mentorim

Ky kurs nje studentet me konceptet e perqatitjes se programit dhe te kursit te mentorimit ne KTN.

MIS41 Mirëqenia holistike e Sherbyesit.

